

UDHËZIM
Nr. 9, datë 3.7.2012

MBI AUDITIMIN DHE INSPEKTIMIN E SIGURISË RRUGORE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 35 pika 3 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 815, datë 23.11.2011 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, si dhe Ministri i Brendshëm

UDHËZOJNË:

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Ky udhëzim ka të bëjë me zbatimin e procedurave në lidhje me auditimin gjatë fazës së projektimit, ndërtimit, si dhe inspektimin gjatë funksionimit të rrjetit rrugor (autostradat, rrugët interurbane, urbane, lokale, përfshirë rrugët, të cilat janë pjesë e rrjetit kryesor të Europës), për menaxhimin sa më të mirë të sigurisë rrugore.

2. Qëllimi i këtij udhëzimi është:

- të përcaktojë procedurat e auditimit dhe inspektimit për aktivitetet e sigurisë në rrugë;
- të përcaktojë kushtet për të vepruar, si dhe për të kryer funksionet si një auditues/inspektor i pavarur;
- të përcaktojë tarifa për aktivitetet e auditimit dhe inspektimit, si dhe për kurset e trajnimit e të testimit;
- të përcaktojë detyrat dhe funksionet kryesore, mbi organet përgjegjëse të auditimit dhe inspektimit në fushën e sigurisë rrugore.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllime të këtij udhëzimi, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) Auditim (Auditim i Sigurisë Rrugore – ASR)

Do të thotë një kontroll i pavarur, sistematik dhe me detaje, mbi çështje teknike të sigurisë rrugore në lidhje me një projekt të infrastrukturës rrugore që mbulon katër fazat e tij, referuar vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 815, datë 23.11.2011 “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 153, datë 7.4.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

b) Auditues (Auditues i Sigurisë Rrugore)

Është një person juridik ose fizik, i cili është i certifikuar dhe kryen funksionet në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me këtë udhëzim;

c) Raporti i auditimit

Është një raport me shkrim, i cili përmban rezultatet e kontrollit me të metat në aspekte të sigurisë rrugore të identifikuara, si dhe rekomandimet;

d) Klienti

Është enti pronar i rrugëve (zakonisht Autoriteti Rrugor Shqiptar, bashkitë, komunat apo

kompani private);

e) Kontraktori

Është një person juridik, i cili është i ngarkuar me kontratë për të ndërtuar një rrugë apo një strukturë inxhinierike në një nivel të përcaktuar edhe në lidhje me sigurinë rrugore;

f) Rrjeti qendror

Do të thotë rrjeti rrugor shtetëror, duke përfshirë rrugët e rrjetit transeuropian, sipas përcaktimeve në aneksin I, neni 2 të vendimit nr. 1692/96/EC.

Sipas karakteristikave të tyre konstruktive, teknike dhe funksionale, këto rrugë janë të tipit A, B, C dhe D.

g) Projektues

Është person juridik, i cili është i ngarkuar me kontratë për të projektuar një rrugë;

h) Inspektim (Inspektim i Sigurisë Rrugore – ISR)

Është një verifikim për të gjetur defektet për arsye të sigurisë, që kërkojnë punime të mirëmbajtjes;

i) Inspektor (Inspektor i Sigurisë Rrugore)

Është një person juridik ose fizik, i cili është i certifikuar në përputhje me këtë udhëzim dhe kryen funksione sipas këtij udhëzimi;

j) Njësia e auditimit dhe inspektimit të sigurisë rrugore (NJAISR)

Është njësi në strukturën organike të entit pronar të rrugëve, të caktuar nga ky udhëzim dhe e ngarkuar për ASR/ISR;

k) Organi i kontrollit në MPPT (OKMPPT)

Është njësi në strukturën organike të MPPT-së e caktuar për monitorimin dhe kontrollin e procesit të auditimit/inspektimit të sigurisë rrugore;

l) Projekt i infrastrukturës

Nënkupton një projekt për ndërtimin e infrastrukturës rrugore të re apo një modifikim të konsiderueshëm të rrjetit ekzistues, i cili ndikon në rrjedhën e trafikut;

m) Segmente me përqendrim të lartë të aksidenteve

Pjesë të rrjetit rrugor të hapura për trafikun, ku për një periudhë më shumë se tre vjet ka pasur një numër të lartë të aksidenteve fatale në përpjesëtim me rrjedhën e trafikut, pra si rrjedhojë një numër të konsiderueshëm të pikave të zeza;

n) Klasifikim i sigurisë së rrjetit

Një metodë klasifikimi e segmenteve rrugore për sa u përket mundësive për përmirësimin e sigurisë rrugore dhe uljes së kostos së aksidenteve.

KAPITULLI II AUDITIMI I SIGURISË RRUGORE

Neni 3

Përfitimet nga Auditimi i Sigurisë Rrugore – ASR

1. Auditimi është një pjesë integrale e një sistemi të menaxhimit gjithëpërfshirës të cilësisë gjatë zgjidhjes së projektimit, në projektin e detajuar, para hapjes së rrugës dhe gjatë funksionimit të rrugës deri në fund të jetës së saj.

2. Kryerja e auditimit, për të cilin bën fjalë ky udhëzim, është i detyrueshëm.

3. Përfitimet që rrjedhin nga procesi i auditimit janë:

a) parandalimi i dëmeve njerëzore dhe materiale, që rrjedhin nga aksidentet e trafikut në rrugën e vlerësuar;

b) shmangia e nevojës për të rindërtuar një rrugë për shkak të mospërputhjes me rregullat e sigurisë në trafik;

c) në përgjithësi auditimi do të bëhet nga një ekip i përbërë nga të paktën dy auditues, ku një anëtar i këtij ekipi, do të mbajë një certifikatë të kompetencës, siç referohet në nenin 11 të këtij

udhëzimi;

d) përzgjedhja e ekipit të auditimit, që kryhet nga ana e NJAISR-së, do të bëhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, të prokurimit të fondeve publike;

e) audituesit do të jenë të pavarur në lidhje me klientin, projektuesin dhe kontraktorin. Ata do të jenë të pavarur në lidhje me NJAISR-në, për aq sa i përket procesit të auditimit;

f) auditimi do të kryhet në përputhje me rregulloret dhe praktikat më të mira në këtë fushë, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Gjatë kryerjes së auditimit, audituesit duhet të përpiqen për të përmbushur kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim;

g) audituesit duhet të përcaktojnë elementet kritike të sigurisë në projekt, në një raport të auditimit për çdo fazë të projektit të rrugës;

h) audituesit do t'i japin rezultatet e auditimit klientit të tyre, NJAISR-së (neni 4), si dhe organit të kontrollit në MPPT (neni 5), dhe asnjë personi apo institucioni tjetër. Ata duhet të kenë konfidencialitet absolut për palët e treta;

i) me kërkesë të NJAISR-së, audituesit duhet të ndihmojnë entet pronare të rrugëve për të përmirësuar udhëzimet dhe rregulloret në fushën e aspekteve të sigurisë rrugore. Ky proces do të jetë subjekt i një pagese shtesë.

Neni 4

Njësia e Auditimit dhe Inspektimit të Sigurisë Rrugore – NJAISR

1. NJAISR-ja është një njësi e veçantë në strukturën organike të entit pronar të rrugës.

2. NJAISR-ja do të jetë njësi e vetme kompetente në fushën e auditimit për rrugët kombëtare dhe rrugët private të hapura për trafikun publik. Për rrugët lokale, kjo njësi do të jetë e atashuar pranë bashkive dhe komunave.

3. Detyrat e NJAISR-së në veçanti janë:

a) për të verifikuar kërkesat që një person të bëhet auditues/inspektor (neni 10);

b) për të përpunuar procedurat e përcaktimit të audituesve/inspektorëve të sigurisë rrugore së bashku me MPPT-në dhe MB-në, procedura, të cilat do të publikohen në faqen e internetit të MPPT-së dhe MB-së;

c) të caktojë audituesin/inspektorin;

d) të mbajë regjistrin (neni 13), e regjistrimit të audituesve/inspektorëve të sigurisë rrugore në rrugë, që do të publikohet në faqen e internetit të MPPT-së;

e) të rregullojë aspektet kontraktuale me klientët, për të paguar sipas kontratës, audituesit/inspektorët e sigurisë rrugore që kanë kryer auditimin/inspektimin e sigurisë rrugore, për rregullimin e informacionit dhe të dokumenteve që rrjedhin në mes palëve të përfshira në procesin e auditimit/inspektimit;

f) të mbikëqyrë kryerjen e auditimeve/inspektimeve, përfshirë pavarësinë e audituesit/inspektorit, sipas këtij udhëzimi;

g) të organizojë takime me audituesit/inspektorët, në lidhje me rezultatet kërkimore shkencore në këtë fushë;

h) të bëjë propozime për përditësimin e legjislacionit, normat, standardet dhe udhëzimet teknike në përputhje me rregulloret europiane dhe praktikat më të mira ndërkombëtare;

i) të marrë pjesë në aktivitete të veçanta në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

4. Detyrat e NJAISR-së miratohen nga MPPT-ja dhe nga këshillat e bashkive dhe komunave.

5. NJAISR-ja përgatit për MPPT-në në çdo 1 mars të vitit pasardhës, një raport vjetor mbi auditimet/inspektimet e kryera, gjatë vitit të sapombyllur.

6. NJAISR-ja mbikëqyret nga OKMPPT-ja.

Neni 5

Organi i kontrollit në MPPT (OKMPPT)

Organi i kontrollit në MPPT (OKMPPT) ka përgjegjësinë e plotë për monitorimin dhe kontrollin e gjithë procesit të auditimit/inspektimit.

Detyrat kryesore të tij do të jenë:

- a) marrja nga klienti dhe krijimi i bazës së të dhënave (*data base*) të audituesve/inspektorëve;
- b) administrimi i të gjitha kopjeve të kontratave midis klientit dhe audituesve/inspektorëve;
- c) administrimi i listës së projekteve për rrugët e reja;
- d) administrimi i listës së investimeve në rikonstruksionin e rrugëve ekzistuese;
- e) kontrolli mbi zbatimin e kontratave dhe propozimin e masave ndëshkuese për rastet e moszbatimit të tyre.

Neni 6

Udhëzuesit dhe manualët

Me qëllim që të mbështesin organet kompetente në zbatimin e këtij udhëzimi, si dhe audituesit/inspektorët për kryerjen e auditimeve/inspektimeve të sigurisë rrugore, miratohet udhëzuesi i auditimit dhe inspektimit të sigurisë rrugore, si pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

Neni 7

Auditimi pjesë e periudhës së hartimit të projektit

Klienti do të llogarisë kohën e domosdoshme për kryerjen e auditimit si pjesë e periudhës gjatë hartimit dhe zbatimit të projektit. Shpenzimet për kryerjen e auditimit do të paguhet nga enti pronar i rrugëve, si pjesë e buxhetit të projektit.

KAPITULLI III

INSPEKTIMI I SIGURISË RRUGORE

Neni 8

Qëllimet e inspektimeve të sigurisë rrugore – ISR

1. Inspektimet e sigurisë rrugore janë verifikime të zakonshme, si dhe ato të planifikuara për efekt të mirëmbajtjes, që kanë lidhje me sigurinë rrugore.

Inspektimet e sigurisë rrugore duhet të kryhen në rrugët në funksionim, në mënyrë që të identifikojnë aspektet e sigurisë në rrugë për të parandaluar aksidentet.

2. Qëllimi i inspektimeve është:

- a) rritja e sigurisë rrugore;
- b) parandalimi i dëmeve njerëzore dhe materiale, që rrjedhin nga aksidentet e trafikut;
- c) mënjanimi i volumeve të mëdha të punës për rindërtimin e rrugëve për shkak të mospërputhjes me rregullat e sigurisë në trafik.

3. Përfitimet e inspektimit të sigurisë rrugore janë analoge me ato të ASR-së (neni 3).

KAPITULLI IV

AUDITIMI DHE INSPEKTIMI I SIGURISË RRUGORE

Neni 9

Anëtarë të administratës së enteve pronare të rrugëve ose të kompanive private

1. Audituesë/inspektorë mund të jenë:

- a) anëtarët e stafit të administratës së entit pronar të rrugës; apo
- b) anëtarët e një institucioni (universiteti) të ngarkuar për auditime; ose
- c) konsulentë privatë që plotësojnë kërkesat për të qenë audituesë/inspektorë.

2. Audituesit/inspektorët mund të jenë anëtarë të stafit të autoritetit shtetëror, ose e ndonjë

autoriteti lokal dhe kanë për të kryer auditimin në njësitë e veçanta të ngarkuara për auditime dhe nuk do të jenë të përfshirë në planifikimin e mëtejshëm, projektimin dhe ekzekutimin e punës në lidhje me rrugën, e cila po auditohet nga ana e tyre. Ata duhet të jenë të pavarur në lidhje me punën që kryejnë për auditimin.

3. Audituesit/inspektorët nuk duhet të jenë anëtarë të stafit të projektimit dhe të kontraktorit të rrugës së cilës ato po i kryejnë auditimin.

Neni 10

Kërkesat për auditues/inspektor

1. Çdo person, i cili dëshiron të bëhet një auditues/inspektor, duhet të plotësojë njëkohësisht këto kërkesa:

- a) një diplomë universitare në fushën e inxhinierisë së ndërtimit, mekanike apo elektrike;
- b) përvojë profesionale në fushën e projektimit të rrugëve ose në fushën e sigurisë rrugore, ose në analiza aksidenti, për të paktën pesë vjet;
- c) pjesëmarrje në kurse trajnimi për auditues dhe pajisja me një certifikatë si auditues/inspektor, sipas kushteve të parashikuara në këtë udhëzim (neni 11);
- d) aftësi fizike për të ushtruar detyrën;
- e) nuk ka kufizim ligjor për ushtrimin e aktivitetit.

Neni 11

Kurse trajnimi, provime, certifikata

1. Një person, i cili dëshiron të bëhet auditues/inspektor i sigurisë rrugore dhe që plotëson kushtet e nenit 10, duhet t'i nënshtrohet një trajnimi të veçantë. Personi duhet të kalojë me sukses një provim për të marrë certifikatën e aftësisë si auditues/inspektor. Marrja e certifikatës së aftësisë nuk përbën trajnim të plotë. Audituesi/inspektori duhet të marrë pjesë në kurse periodike trajnimi të mëtejshme (minimumi një në dy vjet).

2. Programet e trajnimit do të kenë këtë përmbajtje:

- Teori

a) njohuri përkatëse të sigurisë rrugore në standardet dhe rregullat teknike të projektimit të rrugëve;

b) materiale që kanë të bëjnë me procesin e auditimit të vendeve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, që kanë eksperiencë në fushën e auditimit të sigurisë rrugore;

c) udhëzuesi i auditimit dhe inspektimit të sigurisë rrugore.

- Praktika

a) shembuj ushtrimorë dhe pjesë projektesh që kanë të bëjnë me auditimin/inspektimin;

b) studime mbi auditime të mëparshme të projekteve tipike të rrugëve (segmente autostrade, rrugë interurbane, rrugë urbane, rrugë lokale, kryqëzime etj.).

3. Kalendar i zhvillimit të programit:

FAZAT	EMËRTIMI	KOHA
I	Pjesa teorike Raste studimore (auditim/inspektim i rrugëve sipas klasifikimit)	3 ditë
II	Pjesa teori Eksperiencia auditimi të ndryshme nga vende dhe organizma të tjera ndërkombëtare	3 ditë
III	Pjesa praktike Shembull studimor i një projekti kompleks (vlerë e madhe dhe tipologji të ndryshme rrugësh)	2 ditë

IV	Mbyllja e seminarit dhe pajisja me certifikatë	1 ditë
----	--	--------

4. Tarifat e pjesëmarrjes në kurset e trajnimit do të përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon fushën e transportit.

5. Certifikata e dhënë para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi do të njihet me kusht që personi i plotëson kërkesat e këtij udhëzimi.

Neni 12

Trajnuesit, bashkëpunimi

1. Personi i caktuar me cilësinë e audituesit/inspektorit sipas këtij udhëzimi mund të plotësojë kushtet e një trajnuesi për kurset e trajnimit të audituesve/inspektorëve.

2. MPPT-ja do të bashkëpunojë me universitete të akredituara, institucione dhe organizma profesionalë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, që janë me përvojë dhe të autorizuar në fushën e trajnimit profesional, për kryerjen e kurseve të trajnimit dhe programeve të përmirësimit në fushën e auditimeve/inspektimeve. Lista e institucioneve, të parashikuara për bashkëpunim në fushën e auditimeve/inspektimeve, do të bëhet publike në faqen e internetit të MPPT-së, për të qenë e konsultuar nga çdo person i interesuar.

3. Forma e bashkëpunimit do të bazohet në marrëveshjet midis ministrisë që mbulon veprimtarinë e transportit dhe institucioneve referuar pikës 2 më lart.

Neni 13

Regjistri i audituesve/inspektorëve të sigurisë rrugore

1. OKMPPT-ja në përputhje me të dhënat e marra nga NJAISR-ja mbi datën, emrin dhe identifikimin e personave të certifikuar si auditues (neni 11), krijon “Regjistrin e audituesve të sigurisë rrugore.

2. Çdo personi vendas dhe i huaj që i është dhënë cilësia e audituesit/inspektorit jashtë vendit dhe që dëshiron për të kryer aktivitetin e auditimit në këtë vend, ka të drejtë të regjistrohet në “Regjistrin e audituesve/inspektorëve të sigurisë rrugore, në kushtet kur ai paraqet dokumentet që vërtetojnë cilësinë e një audituesi/inspektori të sigurisë rrugore.

3. OKMPPT-ja në përputhje me të dhënat e marra nga NJAISR-ja mbi datën, emrin dhe identifikimin e personave të certifikuar si inspektorë (neni 11), krijon “Regjistrin e inspektorëve të sigurisë rrugore”.

4. OKMPPT-ja në përputhje me të dhënat e marra nga NJAISR-ja mbi datën, emrin dhe identifikimin e personave, të cilët punojnë si trajnerë (neni 12), krijon “Regjistrin e trajnerëve të sigurisë rrugore.

Neni 14

Kontrata

1. Ndërmjet NJAISR-së dhe audituesve/inspektorëve të sigurisë rrugore, do të lidhet një kontratë për performancën e pritshme.

2. NJAISR-ja vendos për auditimet dhe inspektimet që do të kryhen.

3. Audituesi/inspektori nuk mund të refuzojë caktimin nga ana e NJAISR-së për të kryer një auditim/inspektim, përveçse për shkaqe objektive ose për situata të papajtuashmërisë.

Neni 15

Ndërprerja

1. Ndërprerja e kontratës së audituesit/inspektorit mund të bëhet:

a) me kërkesën e audituesit/inspektorit, dërgohet një letër në NJAISR, në të cilën ai deklaron dorëheqjen e tij, duke paraqitur arsyet;

b) me vendim të NJAISR-së në rast se shkelet ndonjë nga pikat e kontratës.
Në rast të ndërprerjes së kontratës, data e ndërprerjes dhe të dhënat e audituesit/inspektorit, do të pasqyrohen në regjistrin e audituesve/inspektorëve.

2. Paragrafi 1 është analog dhe i zbatueshëm edhe në rastin e trajnuesit.

KAPITULLI V PERFORMANCA E AUDITIMIT DHE INSPEKTIMIT NË FUSHËN E SIGURISË RRUGORE

Neni 16

Dokumentacioni teknik i audituesve/inspektorëve

1. Klienti duhet të plotësojë për NJAISR-në dokumentacionin e projektit që do të auditohet, brenda 10 ditësh pune nga data e nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në nenin 15, dhe të njoftojë audituesit/inspektorët e caktuar.

2. Klienti, projektuesi dhe kontraktori do t'i dorëzojnë NJAISR-së dokumentacionin teknik të projektit, që përmban raporte dhe vizatime, si dhe çdo informacion, dokumente, skema, harta apo grafikë të nevojshëm për kryerjen e auditimit në kushte normale. NJAISR-ja do të dorëzojë dokumentet brenda 5 ditëve tek audituesit/inspektorët.

3. Audituesit/inspektorët duhet të ruajnë fshehtësinë mbi informacionin e pranuar, si dhe mbi dokumentet e përpunuara gjatë veprimtarisë së kryerjes së auditimit/inspektimit, me përjashtim të rasteve në të cilat parashikohet ndryshe.

4. Për fazën e 4-t, NJAISR-ja duhet të dorëzojë të dhënat e aksidenteve dhe të dhënat në lidhje me volumin e trafikut.

Neni 17

Papajtueshmëria dhe refuzimi

1. Audituesi/inspektori duhet të informojnë NJAISR-në për çdo rrethanë që ndikon në pavarësinë e audituesit/inspektorit, në lidhje me projektuesin, klientin ose kontraktorin të përfshirë në procesin e auditimit, sapo ai konstaton ekzistencën e një rasti të tillë.

2. Në rastet e refuzimit të kërkesave të auditimit nga ana e klientit me dizavantazhe serioze për sigurinë rrugore, audituesi duhet të informojë me shkrim NJAISR-në dhe mund të kërkojë MPPT-në për ndërhyrje.

Neni 18

Raporti i auditimit/inspektimit

Rezultatet e auditimit/inspektimit duhet të paraqiten nga audituesit/inspektorët në një raport të shkruar dhe të firmosur, në fund të çdo faze të projektit, në përputhje me periudhat kohore të përcaktuara në metodologjinë e auditimit/inspektimit. Raporti i auditimit/inspektimit shpreh qartë dhe saktë mangësitë e identifikuara të sigurisë dhe jep rekomandime.

Neni 19

Përfundimet e raportit të auditimit/inspektimit

1. Është detyrim i klientit për të ndërmarrë veprimet e nevojshme nga rezultatet e raportit, në lidhje me projektuesit dhe kontraktorët, me qëllim që të sigurojë ndërhyrjet e nevojshme para përfundimit të fazës përkatëse të projektit.

2. Në rast se klienti kundërshton kërkesat dhe rekomandimet e raportit të auditimit/inspektimit ai ka për të dhënë një justifikim me shkrim menjëherë për secilin argument.

3. Raporti i auditimit/inspektimit të sigurisë në rrugë dhe arsyetimi me shkrim i klientit duhet

të dorëzohen në MPPT brenda 10 ditëve. Këto dokumente do të bëjnë pjesë në dokumentacionin e projektit.

KAPITULLI VI TARIFAT

Neni 20

Tarifat e auditimit/inspektimit

1. Tarifat për kryerjen e auditimit/inspektimit të sigurisë rrugore do të jenë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 815, datë 23.11.2011.
2. Kushtet dhe mënyra e pagesës së tarifave nga klienti do të përcaktohen me anë të kontratës dhe do të jenë në përputhje me dispozitat.

KAPITULLI VII PËRGJEGJËSITË E KLIENTIT, PROJEKTUESIT DHE KONTRAKTORIT

Neni 21

Kundërvajtjet e ankimueshme

Të drejtat, detyrimet dhe shkeljet e klientit, projektuesit dhe kontraktorit do të parashikohen në kontratat tip, duke përfshirë dhe detyrimet ndaj shkeljeve.

1. Veprat e mëposhtme do të përbëjnë kundërvajtje të ankimueshme:
 - a) Jo pajtueshmëri nga klienti me dispozitat e nenit 10, 11;
 - b) Jo pajtueshmëri me dispozitat e nenit 12, nga projektuesi, klienti dhe kontraktori;
2. Kundërvajtjet sipas pikës 1 do të dënohen sipas dispozitave në fuqi.
3. Konstatimi i kundërvajtjeve të vogla dhënë sipas paragrafit 1 dhe aplikimi i sanksioneve të parashikuara në paragrafin 2, do të bëhet nga personeli i autorizuar nga entet pronare të rrugës.

KAPITULLI VIII PËRGJEGJËSITË E AUDITUESIT/INSPEKTORIT TË SIGURISË RRUGORE

Neni 22

Shkeljet e kontratës

Përgjegjësia kontraktuale e audituesit/inspektorit të sigurisë rrugore është e varur nga shkeljet e mëposhtme:

- a) shkelje e detyrimit të konfidencialitetit;
- b) kryerja e auditimit/inspektimit të sigurisë rrugore në kundërshtim me detyrimet;
- c) kryerja e auditimit/inspektimit të sigurisë rrugore në kundërshtim me metodologjinë e auditimit/inspektimit të sigurisë rrugore.

KAPITULLI IX DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

Neni 23

Rregullat për NJAISR-në

1. MPPT-ja dhe entet pronare të rrugës, do të marrin të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që të sigurohen hapësirat e nevojshme për grupin e kontrollit në MPPT dhe NJAISR, për të kryer

aktivitetin, në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi.

2. Personat që marrin pjesë në kurse trajnimi për auditues/inspektorë të sigurisë rrugore me një kohëzgjatje të caktuar, në vend apo jashtë vendit dhe i plotësojnë kushtet e parashikuara sipas nenit 10, 11, mund të kërkojnë certifikatën e aftësisë së audituesit/inspektorit të sigurisë rrugore dhe për regjistrimin në regjistrin e audituesve/inspektorëve të sigurisë në rrugë.

3. Kërkesa duhet të paraqitet në NJAISR pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, në formë të shkruar, brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të kursit të trajnimit, së bashku me dokumentet që vërtetojnë plotësimin e kushteve.

4. NJAISR-ja pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar verifikon plotësimin e kushteve dhe do të vendosë për dhënien e certifikatës së kompetencës së audituesit/inspektorit të sigurisë rrugore, brenda 15 ditëve nga data e regjistrimit të kërkesës.

Neni 24
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE
DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

MINISTRI I BRENDSHËM
Flamur Noka

UDHËZUES
PËR AUDITIMIN E SIGURISË RRUGORE
2012

PJESA A. INFORMACION MBI AUDITIMIN E SIGURISË RRUGORE

1. BAZAT RRETH AUDITIMIT TË SIGURISË RRUGORE

1.1 Çfarë është auditimi i sigurisë rrugore


Një auditim i sigurisë rrugore është “një ekzaminim formal i një projekti ekzistues apo të ardhshëm rruge ose trafiku, ku një ekip i pavarur dhe i kualifikuar raporton mbi aksidentet e mundshme të projektit dhe gjendjen e sigurisë”.

Auditimi i Sigurisë Rrugore është një vlerësim sistematik dhe i pavarur i treguesve të sigurisë në projektin e infrastrukturës rrugore. Pas parimit “*Parandalimi është më i mirë se kurimi*”, ASR-ja bën të mundur që projektimi dhe ndërtimi i objekteve të trafikut rrugor të jetë sa më eficient dhe i sigurt.

Kjo metodë është shumë efektive për sa i përket kostos. Një ekip i aftë auditimi mund të identifikojë dhe eliminojë një element pasigurie në një projekt rruge, riparimi i të cilit mund të kushtonte shumë më tepër pasi të jetë ndërtuar rruga. Me fjalë të tjera, një auditim i sigurisë rrugore mund të eliminojë një problem sigurie, ndërsa është ende një vijë lapsi mbi një letër, se sa të pritet për ndërtimin e projektit dhe shfaqjen e aksidenteve, si dhe instalimin e masave mbrojtëse të kushtueshme.

Brenda fushës së sigurisë rrugore ndodhen dy procese madhore – njëri është **proaktiv**, dhe synon të **parandalojë** aksidentet, ndërkohë që tjetri është **reaktiv** dhe synon të **zvogëlojë** numrin e aksidenteve në një objekt. Procesi i auditimit të sigurisë rrugore është **proaktiv**, ai identifikon problemet e sigurisë para ndërtimit të një rruge. Rishikimet e pikave të nxehta të aksidenteve, në anën

tjetër, aplikojnë aftësi të ngjashme teknike, por në një mënyrë **reaktive**. Ky proces përdor të dhënat e aksidenteve dhe aftësitë teknike për të ulur pikat e nxehta të taksidenteve.



Aplikimi sistematik i kontrolleve të sigurisë rrugore do të adresojë nevojat e sigurisë të të gjithë përdoruesit e rrugës: shoferët e automjeteve, çiklistët, automjetet bujqësore dhe këmbësorët. Ideja për auditimin e sigurisë rrugore erdhi për shkak të seksioneve të rrezikshme në rrugë dhe interseksioneve edhe përgjatë rrugëve të reja të ndërtuara në shumë vende.

Pas gati dy dekadave të përvojës me auditimin e sigurisë rrugore në të gjithë botën, si në Britaninë e Madhe, Australi, Suedi, Gjermani dhe Danimarkë, kjo procedurë është e njohur si një mjet inxhinierik nga më të rëndësishmet në duart tona. Me direktivën e Parlamentit Europian dhe të Këshillit nr. 2008/96 “Për menaxhimin e sigurisë në infrastrukturën rrugore”, botuar në nëntor 2008, Bashkimi Europian nxori një vendim të qartë të auditimit të sigurisë rrugore, i cili do të jetë i detyrueshëm për rrjetin rrugor transeuropian në vitet e ardhshme. Në direktivë është përmendur ASR-në si pjesë e një pakete të masave të sigurisë rrugore, si në vijim:

- Vlerësimin e ndikimit të sigurisë rrugore;
- Auditimin e sigurisë rrugore për fazat e projektimit të rrugëve;
- Siguri të lartë dhe menaxhimin e rrjetit rrugor në veprim (duke përfshirë menaxhimin e rrezikut të lartë në seksionet rrugore);
- Inspektime të sigurisë rrugore për rrugët ekzistuese;
- Në analizën e thellë në aksident.

Masat e paraqitura janë një pjesë e integruar e menaxhimit të sigurisë rrugore, fig.1:





Figura 1. Auditimi i sigurisë rrugore si pjesë e menaxhimit të sigurisë rrugore
Si pjesë e inxhinierisë së sigurisë rrugore, auditimi i sigurisë rrugore (ASR) ka një marrëdhënie të fortë dhe shumë ngjashmëri me inspektimet e sigurisë rrugore. Ngjashmëritë dhe dallimet e të dyja procedurave shpjegohen në skicën në vijim, figura 2:



* Sipas përcaktimit në direktivën EU nr. 2008/96.

** Inspektimi i sigurisë rrugore (ISR) me përdorimin e udhëzuesit të ISR-së.

*** Pjesë e studimit të fizibilitetit – me asistencën sa të jetë e mundur të audituesve.

Figura 2. VNSR, ASR dhe ISR – fazat dhe përgjegjësitë

Auditimi i sigurisë rrugore (ASR) siguron një shtesë, qasje proaktive për sigurinë dhe kundërmasat në inxhinierinë rrugore.

Auditimi i sigurisë rrugore është:

- një proces formal - jo një kontroll informal;
- një proces i pavarur-merret vetëm me çështjet e sigurisë rrugore;
- kryhet nga persona me përvojën dhe trajnimin e duhur;
- kryhet nga persona të pavarur nga projekti i rrugës;

Rezultati i një ASR-je është një raport zyrtar, i cili identifikon mangësitë e sigurisë rrugore dhe nëse është e përshtatshme, bën rekomandime që kanë për qëllim heqjen apo reduktimin e mangësive. Koha e nevojshme për të ndërmarrë një ASR është shumë e shkurtër në krahasim me fazat individuale të planifikimit. Megjithatë, ajo duhet të konsiderohet si fillim në procesin e zhvillimit të skemës.

Përveç tipareve të sigurisë dhe korrigjimit të mangësive të sigurisë përpara ndërtimit të një rruge, jo vetëm që ndihmon në parandalimin e disa përplasjeve të trafikut rrugor, por edhe shmang nevojën për rindërtimin e shtrenjtë (për të korrigjuar mungesat e sigurisë). Kështu, ASR-ja është potencialisht me kosto shumë efektive.

Një mori e skemave për përmirësim të rrugës, mund të auditohet: projekte kryesore autostrade, projekte rehabilitimi të rrugëve etj. Pas ASR-së, kërkesat e sigurisë rrugore duhet të peshohen kundrejt faktorëve të tjerë në një shqyrtim gjithëpërfshirës.

Është e dobishme për të dalluar ndërmjet tri grupeve apo proceseve në një kontroll të sigurisë rrugore - audituesi apo ekipi i auditimit, ekipi i projektimit dhe klienti apo vendimmarrësi. Funkcioni i çdo grupi është i ndryshëm, dhe rolet e tyre duhet të jenë konsistente dhe të përcaktuara mirë.

Një auditim mund të kryhet edhe mbi një rrugë ekzistuese – në këtë rast ai quhet një inspektim i sigurisë rrugore. Një inspektim i sigurisë rrugore lejon identifikimin e rreziqeve në rrugët ekzistuese para se të çojnë në aksidente. Inspektimet e sigurisë rrugore janë veçanërisht të dobishme në vendet ku nuk disponohen të dhëna të besueshme dhe të sakta mbi aksidentet dhe atje ku ka nevojë për lëvrime të fondeve të kufizuara për riparime në mënyrë eficientë. Normalisht, çdo punë që do të rezultojë nga inspektimi i sigurisë rrugore do të kushtojë, pasi (ndryshe nga një auditim i sigurisë rrugore në një fazë projektimi) duhet alternuar mjedisi i rrugës në fjalë. Disa probleme sigurie të identifikuara nga inspektimi i sigurisë rrugore mund të mos jenë të kushtueshme (p.sh. zëvendësimi i një shenje të vjetër me një të re), ndërkohë që disa të tjera mund të kushtojnë shumë (p.sh. ridrejtimi i një rruge pranë një kryqëzimi për të përmirësuar distancat e pamjes për mjetet që hyjnë). Në përgjithësi, inspektimet e sigurisë rrugore janë më pak eficientë se auditimet e sigurisë rrugore për sa i përket kostos, por që të dyja vlejnë shumë.

Për të qenë eficient, një auditim duhet të kryhet nga profesionistë, të cilët kanë përvojën dhe trajnimin e duhur dhe që janë të pavarur nga projektimi. Në rastin e kryerjes së një auditimi për sigurinë rrugore, projektuesi i projektit të rrugës së re është përgjegjës për projektin. Ekipi i auditimit nuk merr përsipër përgjegjësi për projektin. Ekipi prezanton kontributin e sigurisë rrugore dhe asiston projektuesin e projektit për zvogëlimin e riskut të përdorimit të rrugës së re me aq sa është e mundur. Enti pronar dhe/ose projektuesi marrin në konsideratë një vlerësim të tillë. Projektuesi mbetet përgjegjës për të gjithë vendimet e projektit.

Auditimi i sigurisë rrugore merr në konsideratë sigurinë e të gjithë përdoruesve të rrugës, në të gjitha tipat e rrugëve, siç paraqitet në figurën 3.



Figura 3. Tip përdoruesi rrugë në rrugë interurbane dytësore dhe lokale

Procesi i auditimit të sigurisë rrugore ka tetë hapa kryesorë. Këta hapa jepen më poshtë në tabelën 1.

Hapat e auditimit të sigurisë rrugore	Përgjegjësia e:
1. Përzgjedhja e ekipit të auditimit të sigurisë rrugore	Entit pronar të rrugës
2. Vënia në dispozicion të ekipit të auditimit e të gjithë informacionit rreth projektit	Menaxherit të projektit, ekipit të projektimit dhe entit pronar të rrugës
3. Mbajtja e një takimi fillestar – për përshkrimin e projektit dhe punës	Entit pronar të rrugës, menaxherit të projektit dhe ekipit të auditimit

4. Vlerësimi i problemeve të sigurisë nga vizatimet e projektit. Inspektimi i objektit – gjatë ditës dhe natës	Ekipit të auditimit
5. Të shkruarit e raportit të auditimit të sigurisë rrugore	Ekipit të auditimit
6. Mbajtja e një takimi përfundimtar – për të diskutuar problemet e sigurisë të identifikuara nga auditimi	Entit pronar të rrugës, menaxherit të projektit dhe ekipit të auditimit
7. Përgjigja me shkrim ndaj të gjitha rekomandimeve të raportit të auditimit	Menaxherit të projektit
8. Veprimet pasuese, përfshirë zbatimin e ndryshimeve të miratuara në projekt	Menaxherit të projektit

Tabela 1. Hapat kryesorë në procesin e auditimit të sigurisë rrugore

1.2 Përse duhet auditimi i sigurisë rrugore

Gjatë projektimit, projektuesi bën të gjitha përpjekjet për arritjen e përputhshmërisë me standardet e projektimit dhe kërkesat e entit pronar. Është e çuditshme se si neglizhohen elemente bazë kur ne shkëmbejmë sigurinë rrugore me konsiderata të tjera. Auditimi i sigurisë rrugore është një fushë e specializuar, e cila kërkon kualifikimin e duhur të ekipit që kryen atë (auditimin). Auditimi i sigurisë rrugore lejon ekzaminimin e projektit me qartësi dhe drejtimin e pyetjeve që mund të mos jenë bërë më përpara ose që mund të mos kenë marrë përgjigjen e duhur. Përfitimet nga kryerja e auditimeve të sigurisë rrugore janë:

- minimizimi i shanseve për shfaqjen e aksidenteve në rrjetin rrugor;
- ulja e seriozitetit të aksidenteve dhe rrjedhimisht dhe e kostove të komunitetit;
- dhënia epërsi sigurisë rrugore ndaj konsideratave të tjera;
- shmangia e nevojave për punime riparuese të kushtueshme – është më e lehtë të ndryshosh një projekt se të modifikosh një seksion me rrezik të lartë të një rruge pasi është ndërtuar.

1.2.1 Fazat në të cilat ndërmerret auditimi i sigurisë rrugore

Auditimet e sigurisë rrugore mund të ndërmerren në pesë faza:

- Faza 1: Faza e projektidesë
- Faza 2: Faza e projektit të zbatimit
- Faza 3: Faza e parahapjes
- Faza 4. Auditimi i punimeve në rrugë
- Faza 5: Rishikim i një rruge ekzistuese.

Sa më herët të kryhet një auditim gjatë proceseve të planifikimit dhe projektimit, aq më shpejt eliminohen problemet e mundshme të sigurisë, dhe për rrjedhojë minimizohet edhe koha e humbur për projektimin në fazat e mëvonshme kur ndryshimet janë të nevojshme.

1.2.2 Cilat projekte rrugore duhet të auditohen?

Projektet rrugore që do të auditohen mund të përzgjidhen në përputhje me klasifikimin e rrugëve; madhësinë, koston (lek) dhe tipin e projekteve ose një përzierje e të gjithë këtyre kriterëve. Auditimet e sigurisë rrugore janë të aplikueshme për të gjithë tipat e projekteve të rrugëve, të gjithë tipat e rrugëve dhe të gjitha rrugët ekzistuese. Tabela 2 (më poshtë) jep kriteret për përzgjedhjen e projekteve rrugore që duhen audituar.

1.2.3 Kush duhet ta kryejë auditimin e sigurisë rrugore?

Auditimi i sigurisë rrugore duhet të kryhet vetëm nga një ekip personash me përvojën e mjaftueshme në fushën e sigurisë rrugore.

Ekipi i auditimit ka epërsitë e mëposhtme mbi një auditues të vetëm; përvojat e ndryshme të anëtarëve të ekipit, përpunimi i ideve që mund të rezultojnë nga diskutimet dhe madje thjesht të pasurit më shumë njohuri.

Një auditues i vetëm i sigurisë rrugore, për të qenë i suksesshëm, duhet të ketë përvojë në fushën e sigurisë rrugore dhe aftësinë e hetimit të aksidenteve, si dhe teknikave parandaluese.

Kjo përvojë duhet të jetë e lidhur me kuptimin e:

- inxhinierisë dhe menaxhimit të trafikut;
- teknikat e projektimit dhe të ndërtimit të rrugëve; dhe
- sjelljen e përdoruesve të rrugës.

Njësia e auditimit dhe inspektimit të sigurisë rrugore, në përbërje të strukturës organike të enteve pronare të rrugëve, mund të krijojë një tabelë të dhënash ku mban të regjistruar të gjithë audituesit.

Shumë vende kanë një sistem për regjistrimin e anëtarëve të ekipeve të auditimit në bazë të katër kriterëve që jepen më poshtë:

- të kenë përfunduar një kurs trajnimi mbi auditimin e sigurisë rrugore;
- të kenë pesë vjet përvojë në sigurinë rrugore;
- të kenë kryer të paktën 5 auditime, 3 prej të cilëve kanë qenë në fazën e detajimit;
- të kenë përvojë të vazhdueshme në auditimet e sigurisë rrugore, të kryejnë të paktën një auditim në vit.

Përgjegjësi i ekipit të auditimit duhet të plotësojë të paktën tri kriteret e para, ndërsa një anëtar ekipi duhet të plotësojë të paktën dy kriteret e para.

Para fillimit të një auditimi, duhet të jetë e qartë se si do të trajtohen gjetjet dhe rekomandimet. Gjithashtu, duhet të merren në konsideratë rekomandimet e sigurisë dhe të zgjidhen shkëmbimet e pashmangshme me faktorët e tjerë (siç është kostoja, koha e projektit ose kapaciteti i rrugës).

Preferohet që menaxheri i projektit ose një autoritet tjetër i lartë brenda grupit të projektimit, ose entit pronar të rrugës, ta bëjë këtë dhe të vendosë nëse pranohet ose jo secili rekomandim.

Pavarësisht se gabimet apo sjellja e keqe e drejtuesit të mjetit në përqindjen më të madhe të rasteve, janë shkak i aksidenteve të trafikut rrugor, nga hulumtimet e shumta ka rezultuar se në një pjesë të aksidenteve rruga ka ndikimin e saj, fig. 4.




Figura 4. Kontributi i faktorëve në aksident

ASR-ja është miratuar si një mjet për të përmirësuar faktorët e mjedisit në rrugë. Me njohuritë e ekspertëve të auditimit në kontrollin sistematik të sigurisë rrugore është e mundur për të zvogëluar numrin dhe ashpërsinë e aksidenteve të trafikut, duke përmirësuar performancën e sigurisë rrugore të një projekti të infrastrukturës.

1.3 Kostoja dhe përfitimet e auditimit të sigurisë rrugore

Auditimet e sigurisë rrugore kanë kosto të ulët dhe përfitim të lartë. Procesi i auditimit është një proces i shëndoshë ekonomikisht për t'u adoptuar dhe zbatuar nga entet pronare të rrugëve.

Kostoja e një auditimi të sigurisë rrugore përfshin:

- koston e punës së ndërmarrë nga ekipi i auditimit;
- koston e ndonjë pune riprojektimi që mund të rezultojë nga auditivi; dhe

- koston e ndonjë ndryshimi që mund të rezultojë nga auditimi (duhet pasur parasysh që ndonjëherë, auditimet mund të prodhojnë ndryshime që mund të ulin koston e projektit).

Kostoja e një auditimi do të ketë një vlerë deri 0,3% nga vlera totale e investimit. Sa më e madhe të jetë vlera e investimit, aq më e vogël është kjo përqindje. Kostoja e një auditimi në përgjithësi është me të vërtetë mjaft e vogël. Kostoja e riparimit të ndonjë pasaktësie varet në faktin e hershmërisë së identifikimit në fazën e projektimit dhe kohës së mbetur të projektimit.

Kostot e problemeve mund të bëhen komponenti madhor i koston totale të rrugës mbi të gjithë jetën ekonomike të një projekti nëse në rrugë projektohet një problem serioz sigurie.

Auditimet e sigurisë rrugore të projekteve lejojnë ndryshimin e një vije lapsi mbi një plan më shumë se ndryshimin e gjatësive të betonit apo asfaltit në rrugë. Është më pak e kushtueshme për komunitetin nëse problemi shmanget para se të ndërtohet.

Natyrisht, me rishikimet e sigurisë rrugore të rrugëve ekzistuese, nevoja për trajtimin riparues vihet në dukje pasi është ndërtuar rruga. Por, siguria funksionale e një rruge ekzistuese mund të ndryshojë me kalimin e kohës, siç edhe ndryshojnë volumet, tipat e përdoruesve ose përdorimi i tokave fqinje.

Një rishikim i sigurisë rrugore në një rrugë ekzistuese, kur kombinohet me mjete të tjera në dispozicion të specialistit të sigurisë rrugore, lejon ndërmarrjen e veprimit për të siguruar një nivel sigurie të qëndrueshëm me hierarkinë dhe përdorimin aktual të saj.

1.3.1 Përfitimet nga auditimet

Përfitimet nga auditimi i sigurisë rrugore përfshijnë:

- rrugë të reja më të sigurta;
- reduktim i koston së përjetshme të skemave rrugore;
- uljen e nevojës për modifikimin e skemave të reja pas ndërtimit të tyre;
- kuptim dhe dokumentim më të mirë të elementeve të sigurisë rrugore; dhe
- konsiderim më të dukshëm të nevojave të sigurisë për përdoruesit e rrugës me aftësi të kufizuar.

2. ÇFARË DUHET TË AUDITOHET

2.1 Fusha e aplikimit

Rrugët janë kategorizuar në pajtim me standardet për planifikimin e trafikut, klasifikimin dhe funksionimin e rrjetit rrugor.

Rrugët janë planifikuar, projektuar, ndërtuar, mirëmbajtur dhe operuar në përputhje me standardet përkatëse teknike dhe specififikimet.

Një ASR duhet të ndërmerret në çdo projekt për rrugë të reja apo në ndonjë propozim për ndryshime në rrugët ekzistuese ose mjedis të rrugës që ka të ngjarë të ndryshojë ndërveprime midis përdoruesve të rrugëve të ndryshme apo në mes të përdoruesit e rrugës dhe mjedisin e tyre.

Një ASR është një pjesë integrale e procesit të projektimit, por i pavarur nga projekti aktual. Projektuesi i rrugës së re (ose projekt tjetër i aplikueshëm) mbetet përgjegjës për projektin. Projektuesi duhet të bëjë verifikime të rregullta të implikimeve për sigurinë e punës për përparimin e projektit.

ASR-ja nuk e ndryshon nevojën për një perceptim “siguria e para”. Procesi i auditimit ofron, në intervale të rregullta, një vlerësim të pavarur.

Klienti mbetet përgjegjës për projektin përfundimtar dhe duhet të marrë në konsideratë vlerësimet. Në këtë udhëzues, klientë të tillë si: entet pronare të rrugëve kombëtare dhe lokale, ndërmarrjet publike për rrugët publike dhe në raste të veçanta, donatorët e mjeteve financiare janë në çdo rast përfundimtarë dhe vendimmarrësit e rregullt në procesin e projektimit.

Ky udhëzues për auditimin e sigurisë rrugore në projektet e rrugëve, është i zbatueshëm për:

- rrugë të reja, rrugë dhe objekte të tjera të trafikut rrugor;
- projekte të rrugëve (që po rishfaqen, restaurohen, rehabilitohen);
- ndërtime brenda dhe jashtë zonave.

Për rrugët që janë ndërtuar, kushtet mund të kenë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme, për shembull standardet e projektimit, funksioni i rrugës, vëllimi dhe shpërndarja e trafikut, pesha e automjeteve, përdorimi i tokës, dhe hyrjet, të gjitha mund të ndryshojnë. Sipas direktivës 2008/96/CE

e 19 nëntorit 2008 “Mbi menaxhimin e sigurisë në infrastrukturën rrugore”, auditimi i sigurisë rrugore në fazën finale duhet të kryhet për të parë nëse do të ndodhin probleme të sigurisë në muajin e parë pas hapjes së rrugës.

Për më tepër kjo është e rëndësishme, nga koha në kohë, të inspektojë periodikisht rrjetin ekzistues rrugor me fokus të sigurisë rrugore. Kjo detyrë mund të jetë e koordinuar me hetimin e seksioneve rrugore të rrezikut të lartë. Kjo procedurë është quajtur Inspektimi i Sigurisë Rrugore (ISR) dhe si pasojë do të plotësohet nga një udhëzues për inspektime të sigurisë rrugore në rrugët ekzistuese.

Ky udhëzues jep më shumë detaje në lidhje me procesin e ISR-së.

2.2 Llojet e projekteve

Llojet e projekteve që do të auditohen, detyrimisht do të përcaktohen në bazë të rregullave ligjore.

ASR-ja mund të kryhet për të gjitha llojet e projekteve të rrugëve, edhe pse është mjaft e qartë, se projektet lidhur me rrjetin kryesor të cilat i shërbejnë një vëllimi të lartë të trafikut duhet të jenë në fokusin e administratës.

ASR-ja duhet të zbatohet në mënyrën e mëposhtme:

- në çdo rast për trafikun në projektet e infrastrukturës rrugore me një karakter të detyrueshëm sipas dispozitave ligjore;

- duhet të përdoret edhe për pjesë të tjera të rrjetit kryesor;

- rekomandohet edhe për masat në rrjetin sekondar.

ASR-ja mund të përdoret për rrugët interurbane, si dhe për arteriet urbane.

Asnjë projekt nuk është i vogël për ASR-në:

- projektet e mëdha, p.sh.: Autostradat, rrugët interurbane, anashkalime (*bypass*) etj.;

- projektet mesatare, p.sh.: projektet e rindërtimit dhe të rehabilitimit;

- përmirësime të vogla, p.sh.: rimodelime të vogla, objekte të reja të biçiklistëve, rindërtime

të vogla.

- mirëmbajtje e veprave të mëdha, p.sh., mund të jetë bërë për pjesë të veçanta si shënues ose parrakë metalikë.

Duke pranuar nevojën për aplikimin e burimeve aty ku kanë efektin maksimal, auditimet e sigurisë rrugore në projektet e rrugëve të reja duhet të përzgjedhin fazat në përputhje me koston e projektit të rrugës siç jepen në tabelën 2.

FAZA E AUDITIMIT	Kostoja e projektit të rrugës		
	Projekte të mëdha (1)	Projekte të mesme (2)	Projekte të vogla (3)
Planifikimi	Të gjitha projektet	Nuk kërkohet	Nuk kërkohet
Projektideja	Të gjitha projektet	Të gjithë projektet (4)	Sipas gjykimit të inxhinierit projektues (5)
Projekti i zbatimit	Të gjitha projektet		
Parahapja	Të gjitha projektet	Të gjithë projektet	
Punimet në rrugë	Çdo punim rruge që do të qëndrojë/përdoret për më shumë se dy muaj		
Rishikimi i rrugës ekzistuese	Rrugët kryesore duhet të auditohen çdo vit, sipas gjykimit të entit pronar, dhe në varësi të burimeve		

Tabela 2. Kriteret e auditimit të projekteve

Shënime.

1. Projekte të mëdha janë ato, vlera totale e të cilave kalon shumë 100 milionë lekë.
2. Projekte të mesme janë ato, vlera totale e të cilave është mbi 25 milionë lekë.
3. Projekte të vogla janë ato, vlera totale e të cilave është poshtë 25 milionë lekë.
4. Këto projekte mund të auditohen nëse cilën prej fazave të dhëna.

5. Këto projekte mund të auditohen nëseçilën prej tri fazave të dhëna. Projektet e sugjeruara kryesisht për të përfituar nga një auditim do të përfshijnë ato me shumë konflikte ndërmjet automjeteve dhe përdoruesve të tjerë të rrugës (kryqëzimet e ngarkuara), ku ka shpejtësi të mëdha, ose ku priten ndryshime të mëdha të situatës ekzistuese të trafikut.

Auditimi i sigurisë rrugore merr në konsideratë sigurinë e të gjithë përdoruesve të rrugës, në të gjithë tipat e rrugëve.



KËSHILLA SIGURIE PËR EKIPET E AUDITIMIT - KËMBËSORËT



TË MENDOHET GJITHNJË PËR GRUPET E KËMBËSORËVE

Tri grupet më të dobëta të këmbësorëve janë të rinjtë, të moshuarit dhe të intoksikuarit. Kur ndërmerret një auditim i sigurisë rrugore, gjithnjë duhet të mendohet për nevojat e sigurisë për të gjitha kategoritë e këmbësorëve – nevojat e sigurisë të të rinjve, të moshuarve dhe të intoksikuarve.



SIGURIMI I TRAFIKNDARËSVE TË GJERË

Trafikndarësit ndihmojnë këmbësorët në kalimin e rrugës duke pasur një vend të sigurt për të pritur për secilin fluks/drejtimit trafik. Në disa projekte rrugësh, trafikndarësit janë ndërtuar me gjerësi maksimale prej 1m (nga bordura në bordurë). Kjo gjerësi është e pamjaftueshme për mbajtjen e sigurt të këmbësorëve. Trafikndarësit duhet të jenë minimalisht 1.8 m të gjerë dhe duhet të jenë të mbushur dhe jo gropë. Qëndrimi në trafikndarës të paniveluar është i vështirë, veçanërisht për të moshuarit, gjë që mund të çojë në rënien e tyre në trafik.



RISHIKIMET E SIGURISË RRUGORE DUHET TË KENË PARASYSH GJITHMONË KËMBËSORËT

Mirëmbajtja e trotuareve nga gropat dhe defektet e tjera është e rëndësishme për sigurinë e këmbësorëve. Nëse trotuaret nuk e kryejnë më shërbimin e tyre, këmbësorët do të fillojnë të ecin në rrugë, një veprim ky me risk të madh.

KËSHILLA SIGURIE PËR EKIPET E AUDITIMIT - KËMBËSORËT



TROTUARET NË RRUGËT RURALE

Mjetet motorike me shpejtësi të lartë dhe këmbësorët nuk duhet të përzihen. Projektet për rrugë të reja duhet të marrin në konsideratë të gjithë përdoruesit e rrugës. Siguria rrugore ndihmohet nga trotuaret ose bankinat e gjera të ngritura.



QËNDRIMET E AUTOBUSËVE

Qëndrimet e autobusëve duhet të shënohen qartë dhe duhet të jenë larg nga kryqëzimet. Duhet të sigurohet një zonë e pastër për pritje për këmbësorët larg nga korsitë e trafikut. Shumë qytetarë janë pasagjerë autobusësh dhe si të tillë meritojnë akses të sigurt për ta dhe nga autobusët.



SHKOLLAT

Duhet të kihet parasysh efekti i rrugës së re mbi shkollat, spitalet, dyqanet dhe ambientet sportive në afërsi të saj. Shkollat janë destinacioni kryesor për këmbësorët e rinj. Në zonat e dendura urbane, kalimet e kontrolluara në vijat e këmbësorëve (si p.sh. në afërsi të shkollës) janë thelbësore.

KËSHILLA SIGURIE PËR EKIPET E AUDITIMIT – MENAXHIMI I RREZIQEVE ANËSORE NË RRUGË

Rreziqet anësore janë një risk i madh për sigurinë rrugore në rrugë. Ekipi i auditimit të sigurisë rrugore duhet të kuptojë strategjinë prej pesë hapash që përdoret për menaxhimin e rreziqeve anësore dhe për uljen e riskut që i kanoset përdoruesve të rrugës:

Hapi 1 – Mbajtja e automjeteve në rrugë.

Hapi 2 – Largimi i objekteve të fiksuara nga anët e rrugës (brenda zonës së sigurt të përcaktuar).

Hapi 3 – Rivendosja e rreziqeve/pengesave larg rrugës (jashtë zonës së sigurt të përcaktuar).

Hapi 4 – Mënjanimi i rreziqeve për të ulur seriozitetin e përplasjeve.

Hapi 5 – Mbrojtja e automjeteve lëvizës nga rreziqet me parapetë sigurie.

Hapi 1 – Mbajtja e automjeteve në rrugë

Për arritjen e kësaj, duhet një kombinim i mirë i projektimit gjeometrik me informacionin për drejtuesit e automjeteve dhe mirëmbajtjen e rrugëve. Bankinat e ngritura, bordurat e fiksuara kufizuese, treguesit e tjerë kufizues dhe shenjat e drejtimit luajnë rol në uljen e aksidenteve me dalje jashtë rruge.

Hapi 2 – Largimi i rreziqeve nga “zona e sigurt”

Të gjitha objektet e fiksuara (me diametër 100 mm ose më shumë) duhet të largohen nga “zona e sigurt” (në anë të rrugës – gjerësia e saj varet nga shpejtësia dhe volumi i trafikut). Në rrugët me shpejtësi të larta, një zonë normale sigurie është 10 m e gjerë.



a)



b)

Një shtyllë e parrethuar, përbën një rrezik serioz në rrugë, veçanërisht në zonat me shpejtësi të larta (a). Gjithashtu dhe një parapet betoni që shërben si trafikndarës, i pambrojtur përbën një rrezik shumë serioz (b).

Hapi 3 – Rivendosja e rreziqeve/pengesave larg rrugës (jashtë zonës së sigurt të përcaktuar)

Nëse rreziqet anësore nuk mund të largohen përfundimisht, varianti tjetër është rivendosja e tyre në një pozicion që ofron nivel më të lartë mbrojtjeje për automjetet. Largimi i tyre nga kufiri i rrugës u jep drejtuesve të automjeteve më tepër kohë dhe hapësirë për të shmangur përplasjet serioze. Projektimi i një tombinoje për të zgjeruar rrugën çon kokën e tombinos shumë më larg/anash, duke ulur kështu riskun, vetëm me një rritje të vogël të kostos së ndërtimit.

Hapi 4 – Mënjanimi i rreziqeve për të ulur seriozitetin e përplasjeve

Nëse eliminimi apo largimi i rreziqeve nga zona e sigurt nuk është i mundur, atëherë një variant projektimi i një problemi që toleron/fal më shumë për automjetin dhe personat në të.

Shtyllat e ndriçimit dhe mbajtëset e shenjave mund të projektohen të tilla që të bien pas përplasjes duke

ulur kështu seriozitetin e dëmtimeve të personat në automjet.

Hapi 5 – Mbrojtja e automjeteve lëvizëse nga rreziqet me parapetë sigurie.

Kur janë konsumuar katër hapat e parë strategjike, mund të përdoren parapetët e sigurisë. Qëllimi i parapetëve të sigurisë është mbrojtja e qenieve njerëzore që ndodhen në automjetin në lëvizje nga përplasja me rreziqun. Duhet pasur parasysh se edhe një parapet sigurie është një objekt i fiksuar dhe mund të shkaktojë dëme kur goditet. Përpiquni të minimizoni përdorimin e tyre. Garantoni projektimin dhe instalimin korrekt të tyre.

Ekipet e auditimit duhet t'i shohin me imtësi projektimet e parapetëve të sigurisë

Parapetët e sigurisë, pavarësisht nga emri i tyre, mund të përbëjnë një rrezik më vete. Duhet të merren të gjithë hapat e mundshëm për eliminimin e nevojës për to, që nga projektimi i mirë e deri te praktikat ndërtimore. Një parapet sigurie duhet të instalohet vetëm atëherë kur mendohet se serioziteti i një përplasjeje me një objekt të fiksuar do të jetë më i lartë se i një përplasjeje me vetë parapetin. Ekzistojnë tri kategori parapetësh sigurie:



Parapetët fleksibël – që përmbajnë një numër litarësh teli të lidhur me fije çeliku në hapësira 2.4 m. Kur parapeti goditet nga një automjet, litarët devijojnë, duke drejtuar automjetin përgjatë parapetit ndërkohë që rënia progresive e shtyllave thith energjinë kinetike të automjetit duke e ngadalësuar atë. Kur disponohet gjerësia e duhur e devijimit, kjo siguron një barrierë shumë më lehtësuese se çdo lloj sistemi tjetër të sertë.



Parapetët gjysmë të sertë – përgjithësisht parapetë çeliku në formë E-beam. Duhet të kenë aftësinë e ridrejtimit dhe/ose mbajtjen e një automjeti, ndërkohë që, nuk diktohen forca të patolerueshme ngadalësimi të personat në automjet.



Parapetët e sertë – këta janë parapetë betoni dhe nuk deformohen ose devijohen kur goditen. Ata përdoren kryesisht si parapetë për mesin në rrugë me volume dhe shpejtësi të lartë ose në ura. Fundet e këtyre parapetëve paraqesin një rrezik serioz për sigurinë rrugore dhe duhet të mbulohen/mbrohen në një mënyrë të miratuar.

PJESA B. KRYERJA E AUDITIMIT TË SIGURISË RRUGORE

3. KUR DUHET TË KRYHET AUDITIMI

3.1 Fazat

Sipas përvojës në Europën Perëndimore dhe direktivës 2008/96/CE, ka katër faza të ndryshme gjatë së cilës duhen kryer auditimet e sigurisë rrugore:

- Faza 1: draftprojekti (ose projektideja);
- Faza 2: projekti i zbatimit;
- Faza 3: parahapja e rrugëve; dhe
- Faza 4: rishikim i një rruge ekzistuese, kur rruga është disa kohë në funksion.

Vlerësimi i fazës së projektidesë (studim paraprak apo planifikimit) duhet të bëhet duke përdorur metodën e vlerësimit të ndikimit të sigurisë rrugore.

Procesi ASR fillon me vendimin për ndërtimin e një rrugë të re ose në investimin për rikonstrukcionin, zgjerimin ose mirëmbajtjen e një rruge ekzistuese.

Në rastin e rrugëve të reja procesi i auditimit zakonisht fillon pas vlerësimit të ndikimit të sigurisë rrugore dhe fazës së studimit të fizibilitetit, në qoftë se afati i shtrirjes i propozuar është i mjaftueshëm për të bërë një kontroll të arsyeshëm.

Faza 1 dhe 2 e ASR-së do të kryhet në bazë të dokumentacionit të projektimit (vizatimeve, raportet shpjeguese etj.) të projektit. Për të siguruar një saktësi të duhur të ASR-së, dokumentacioni i projektimit duhet të ketë cilësi dhe përmbajtje të mjaftueshme.

Para hapjes për trafik të një rrugë të re në fazën e 3-të të auditimit duhet të bëhen kontrole nëse skema është projektuar dhe ndërtuar në lidhje me sigurinë rrugore dhe nëse çdo gjë tjetër e pazbuluar më parë ka dalë në dritë gjatë ndërtimit. Faza përfundimtare (faza 4) e procesit të ASR-së është monitorimi i operacioneve të hershme. Është e rëndësishme që një vlerësim i situatës aktuale të sigurisë të bëhet pas disa muajsh.


Në rastin e projekteve të vogla, si: projektet e rindërtimit, drafti i projektit të detajuar janë të përgatitur vetëm rrallë. Në këtë rast do të bëhet një auditimi i vetëm i kombinuar për dyja fazat e para ASR-së.

4. PROCESI I AUDITIMIT – SI BËHET PËR TË KRYER NJË ASR


4.1 Partnerët në procesin e auditimit dhe rolet e tyre.

Klienti (zakonisht enti pronar i rrugës, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit ose kompani private rrugore), projektuesi dhe audituesi, janë pjesë e procesit të auditimit. Klienti nis auditimin e sigurisë dhe komisionet apo ekipin e auditimit. Të gjitha informatat dhe raportet janë shpërndarë nëpërmjet klientit.

Model 1. Raste normale në shumë vende.



Model 2. Grafik organizativ i përmirësuar.



* Njësia e auditimit dhe inspektimit të sigurisë rrugore (pjesë e çdo strukture organike të enteve pronare të rrugëve).

** Organi kontrollit në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit.

Figura 5. Partnerët në procesin e Auditimit – dy modelet e mundshme

Skema e përmirësuar organizative për ASR-në, siç është treguar në figurën 5 (model 2), do të ndihmojë që të ketë një kapacitet të mjaftueshëm për ndërtimin e ASR-së dhe do të sigurojë cilësinë e ASR-së. NJAISR-ja, si një njësi e veçantë në strukturën organike të entit pronar të rrugës, është vetëm një sugjerim për të siguruar cilësi të nevojshme të ASR-së, gjithashtu, mund të delegojë detyrat për sigurinë rrugore institutëve ose agjencive.

Klienti është institucion i cili kërkon nga projektuesi hartimin e projektit. Klienti është përgjegjës për kushtet themelore të projektit. Kjo përfshin edhe përgjegjësinë që të arbitrojë në rastet kur audituesit dhe projektuesit nuk pajtohen. Kjo mosmarrëveshje do të paraqitet te klienti. Klienti duhet të përgatisë një vendim formal me shkrim për projektuesit dhe audituesit. Në rast të fazës 4 në mirëmbajtjen e rrugëve, njësia e inspektimit duhet të përfshihet në proces.

Është përgjegjësi e plotë e klientit për të siguruar që kërkesat e auditimit do të pranohen. Klienti duhet të bëjë të qartë në kontratat e tij me projektuesin dhe kontraktorin, detyrimin e projektuesit ose kontraktorit në lidhje me ndryshimet e nevojshme. Është detyrë e klientit për të organizuar që shpenzimet e nevojshme për zbatimin e rezultateve të ASR-së do të mbulohen nga buxheti i investimeve totale.

Një specialist i auditimit të sigurisë rrugore dhe njësisë së auditimit dhe inspektimit - NJAISR ose agjencisë së sigurisë rrugore dhe një organi të kontrollit në nivel të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit - OKMPPT - mund të ndihmojnë entet pronare të rrugëve në ASR/ISR.

Projektuesi është përgjegjës për projektin. Ai ka përgjegjësi të plotë për të siguruar një paraqitje të mjaftueshme teknike të sigurisë rrugore. Detyrimi i projektuesit është gjithashtu që të gjitha dokumentet e projektimit të përmbajnë informacion me të dhëna të auditimit në një mënyrë të qartë.

Në qoftë se projektuesi nuk mund të pajtohet me kërkesat e raportit të auditimit, ai duhet të paraqesë arsyet me shkrim në mënyrë që Klienti të marrë një vendim. Së fundi duhet që dhe projektuesi të bindet me rezultatet e raportit të ASR-së pas vendimit përfundimtar të marrë nga klienti. Pavarësisht nga faza e projektimit dhe lloji i ndryshimeve që kërkohen, ndryshimet e nevojshme mund të bëhen në të tashmen ose në fazën e projektimit të ardhshëm.

Audituesi është subjekt juridik, ekip ose organizatë tjetër që do të kryejë ASR-në në bazë të materialit të projektimit ose gjendjes së rrugëve në ndërtim e sipër ose në fillim të operacionit. Është

rekomanduar, sipas praktikave më të mira në vendet e tjera, për të mbështetur procedurën e pavarur të auditimit, për të shmangur kontaktet direkte ndërmjet audituesit dhe projektuesit. Një diskutim në fillim me projektuesin mund të çojë në një situatë që projektuesi kërkon të ketë ndikim në rezultatet e auditimit dhe mund të zvogëlojë efikasitetin e ASR-së. Megjithatë një takim plotësues mund të jetë pjesë e hapit përfundimtar të ASR-së (shih 4.2.3). Eksperti i auditimit është përgjegjës për të kontrolluar dokumentacionin në një mënyrë të kujdesshme, me sigurinë rrugore në fokus. Me një raport zyrtar me shkrim subjekti auditues duhet të paraqesë gjetjet, mangësitë dhe propozimet.

Kjo nuk është detyrë primare e subjektit auditues për të kontrolluar nëse përputhet ose jo një projekt me standardet rrugore. Në të kundërtën, është shpesh e nevojshme për të shkuar përtej standardeve rrugore. Audituesi do të përdorë njohuritë e tij në lidhje me praktikën më të mirë në vlerësimin e një projekti. Është e rëndësishme që audituesit të kenë përvojë të thellë në projektimin e ndërtimit të rrugëve, si dhe sigurinë rrugore, inxhinieri dhe analizat e aksidentit. Për të siguruar cilësinë e auditimit, audituesit duhet t'i nënshtrohen një trajnimit fillestar në dhënien e një certifikate të kompetencave dhe duhet të marrin pjesë në kurse të tjera trajnimit periodik.

Fazat e auditimit 3 dhe 4 duhet të bëhen të preferueshme nga audituesi i cili ka zgjidhur edhe auditimin e fazave të projektimit. Është gjithashtu e mundur që të delegojë detyrën e fazës 4 - në fillim të operimit - për një ekip të inspektorëve të Sigurisë Rrugore.

4.2 Kalendar i punës për ASR-në

Për shkak të përcaktimit të potencialit të plotë të ASR-së, ajo duhet të jetë e organizuar me një strukturë efektive dhe me përgjegjësi të qarta. Më poshtë përshkruhet procesi tipik i auditimit, bazuar në figurën 6, që vijon më poshtë.

Procedura e përgjithshme e ASR-së, do të përfshijë tri faza kryesore:

- urdhërimin;
- marrëveshjes; dhe
- përfundimit.

Pavarësisht qëllimit dhe natyrës së një projekti të infrastrukturës rrugore dhe pa marrë parasysh fazën e auditimit, është e mundur për të kryer ASR-në në bazë të këtij diagrami. Ajo ka për t'u përmendur se në fazën e ASR-së 3 dhe 4 në shumicën e rasteve nuk do të jetë e nevojshme punë projektimi, shpesh ndryshimet mund të jenë të organizuara direkt nga kompania e ndërtimit (kontraktori) për fazën e 3, ose njësisia mirëmbajtjes së klientit për fazën 4. Kjo varet nga lloji i ndryshimeve në projekt, nëse ajo do të jetë e nevojshme të ketë një përsëritje të pjesës së ASR-së për të kontrolluar dokumentacionin e ndryshuar. Në rast dyshimi klienti duhet t'ia dërgojë audituesit dokumentet përkatëse.






Figura 6. Zhvillimi i procedurave të ASR-së (hapat kryesorë)

Për të garantuar cilësinë e qëndrueshme të ASR-së, tërë procesi duhet të jetë kontrolluar dhe dokumentuar nga një organ i kontrollit në nivel të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (OKMPPT). Raporti ASR, i dorëzuar klientit për regjistrim përfundimtar duhet të jetë mbledhur si një dëshmi.

4.2.1 Renditja e auditimit të sigurisë rrugore renditja e auditimit

Zakonisht, vendimi për të audituar është marrë nga klienti. Secili prej hapave të auditimit (të dhëna më sipër) duhet të përshtaten me natyrën dhe shkallën e projektit të rrugës. Për shembull, një auditim për një projekt të vogël rruge mund të kërkojë thjesht një telefonatë në vend të një takimi fillestar, dhe raporti mund të konsistojë në pak faqe nëse nuk ka probleme serioze. Një auditim për një

projekt të madh rruge pritet të kërkojë takime, një numër të madh planesh dhe një raport me shumë faqe.

Menaxheri i projektit është përgjegjës për planifikimin, projektimin dhe ndërtimin e projektit dhe nuk është në rolin e ekipit të auditimit të projektit të marrë përsipër këto përgjegjësi apo të riprojektojë projektin. Roli i ekipit të auditimit është të sigurojë këshillë të pavarur në formën e rekomandimeve me shkrim. Kjo këshillë merret në konsideratë nga menaxheri i projektit, i cili vendos për ndërmartjen ose jo të secilit prej veprimeve të sigurisë të rekomanduara.

Përzgjedhja e ekipit

Grupet e auditimit, duhet të jenë jo më pak se dy persona. Në mënyrë ideale, ajo duhet të jetë një ekip me aftësi të ndryshme të përshtatshme për të projektuar.

Një ekip auditimi duhet të dalë nga një listë personeli të përshtatshëm të regjistruar. Për përzgjedhjen e një anëtari të përshtatshëm për ekipin e auditimit duhet të bëhen pyetjet e mëposhtme:

- A është audituesi i pavarur?
- A është trajnuar audituesi në një seminar të miratuar?
- A i ka audituesi aftësitë e nevojshme?
- A është audituesi në gjendje t'i shikojë problemet e mundshme të sigurisë nga pikëpamjet e ndryshme të përdoruesve të rrugës?

Një person në ekip duhet të emërohet si udhëheqës ekipi për të menaxhuar ekipin dhe procesin. Përgjegjësi i ekipit është përgjegjës për menaxhimin e auditimit, komunikimin me ekipin e projektit dhe garantimin e përfundimit të raportimit në kohë. Përgjegjësi i ekipit duhet të jetë anëtari me më shumë përvojë në ekipin e auditimit dhe do të jetë ai që udhëheq dhe udhëzohet anëtarët e tjerë të ekipit.

Natyrë dhe sinteza e ekipit varet nga kompleksiteti i detyrës së auditimit dhe madhësia dhe lloji i skemës që auditohet. Ajo gjithashtu mund të ndryshojë për çdo fazë të auditimit. Përfitimi kryesor i ekipit është të pasurit e një shkëmbimi të përvojave të ndryshme, njohuri dhe qasje të ekspertëve të ndryshme.

Dy fazat e projektimit duhet të ndërmerren nga auditues me shumë përvojë, duke përfshirë specialistë të sigurisë rrugore, specialistë të hetimit të aksidenteve dhe inxhinierë projektues rruge.

Në fazën e projektit të detajuar llojet e aftësive të kërkuara për të thirrur një ekip ekspertësh me përvojë në projektimin e rrugëve, sinjalet e trafikut, ndriçimit dhe kullimit, përdoruesit jo të motorizuara etj.

Në fazat e parahapjes dhe pashapjes, është e rëndësishme për t'u marrë parasysh në ekipin e ekspertëve, përvoja në lidhje me të gjitha aspektet e mirëmbajtjes së objektit duke përfshirë sinjalet, ndriçimin, kontrollin e trafikut, bimësinë, heqja e dëborës etj. Kjo mund të jetë e dobishme për të përfshirë një punonjës policie, i cili ka përvojë në sigurinë rrugore dhe hetimin e aksidentit.

Përbërësi kryesor i një ekipi të auditimit të sigurisë rrugore është përvoja në fushën e sigurisë rrugore. Përveç kësaj, është gjithashtu e rëndësishme përzgjedhja e personave me përvojën përkatëse: për një projekt për autostradë apo rrugë lokale/qyteti; për një projekt urban apo rural.

Auditimet në faza të ndryshme kërkojnë aftësi të ndryshme pa përjashtuar familjaritetin me parimet dhe praktikën në fushën e sigurisë rrugore, duke u përqendruar në aftësitë që janë të përshtatshme për fazën e auditimit dhe madhësinë e projektit në fjalë.

- **Faza e projektidesë:** Ekipi i rekomanduar në këtë rast mund të përbëhet nga një inxhinier projektues rrugësh, i cili është i familjarizuar me standardet e projektimit të rrugëve dhe mund të vizualizojë shtrirjen në tri dimensione, si dhe të paktën njëri prej audituesve duhet të ketë njohuri mbi aktivitetet e përdoruesve vendas të rrugës, si dhe përvojë në projektim.

- **Faza e projektit të zbatimit:** Rekomandohet përfshirja në ekip e një personi me eksperiencë në kontrollin e sinjaleve rrugore, në (vetë) sinjalet e sinjalizimit rrugor, ndriçimin e rrugëve, ambientet për biçikletat, parapetetëve ose çështjeve të tjera të përdorimit të rrugës.

- **Faza e parahapjes:** Këtu mund të konsiderohet përfshirja e një oficeri policie me përvojë në çështjet e trafikut dhe sigurisë rrugore, ose ndoshta një inxhinier mirëmbajtjeje, apo dikush i njohur me anën e sjelljes së përdoruesve të rrugës.

- **Faza e punimeve në rrugë:** Rekomandohet përfshirja e një personi me përvojë në menaxhimin e objektit (rrugës) në ndërtim dhe një inxhinier i njohur me detajet e kontrollit të trafikut dhe mjetet e sigurisë që përdoren në objekte në ndërtim.

- **Rishikimet e sigurisë në “Rrugët ekzistuese”:** Rekomandohet përfshirja e profesionistëve me përvojë në fushën e sigurisë rrugore.

Mbledhja e informacionit të dokumentuar dhe përmbledhja e auditit

Informacioni i mbledhur i shërben ekipit të auditimit si udhëzim i mjaftueshëm për skemën që do të ndërmerret, si dhe për të mundësuar ekipin që të zhvillojë auditimin në mënyrë të kënaqshme.

Është e rëndësishme që ekipit të auditimit i janë dhënë të gjitha dokumentet e kërkuara në fillim. Dokumentet e pakompletuara të çojnë në pyetjet dhe kërkesat shtesë, duke rezultuar në më shumë kohë dhe punë që kërkohet për auditim.

Një minimum i mundshëm i dokumentacionit duhet të jetë:

- një përshkrim të shkurtër të projektit;
- një llogari të kushteve të projektit dhe parametrat e projektimit (shpejtësia e projektimit, rrezja e kthesave, mbilartësia, kriteret e syve, volumin e trafikut, të dhënat e aksidenteve etj.);
- një sasi vizatimesh (e detyrueshme në letër, jo vetëm digjital);
- detajet dhe arsyet për çdo devijim nga standardet e rrugëve;
- çdo auditim të mëparshëm të sigurisë rrugore, raportet e inspektimit.

Një rekomandim në lidhje me kërkesat minimale për përmbajtjen e dokumentacionit është treguar në tabelën që vijon.

Për operacionin e fazës fillestare mund të jetë e dobishme që të ketë të njëjtat dokumente, si për shembull në lidhje me volumin e trafikut të hapjes.

Në çdo rast është e nevojshme që grupi i ASR-së të ketë raportin përkatës në një fazë të mëparshme.

Projektideja	Projekti i zbatimit	Hapja e trafikut
Raporti shpjegues me. Analiza e trafikut gjithëpërfshirës me prognozën e volumit të trafikut	Rezultati i auditimit të fazës së mëparshme me vendim të Klientit	Rezultati i auditimit të fazës së mëparshme me vendim të Klientit
Diagrama aksidenteve dhe hartat me pika të zeza dhe zgjedhja e rrugëve të rrezikshme	Raporti shpjegues	Raporti shpjegues
Harta përmbledhëse me: planet e vendndodhjes me tipat e kryqëzimeve	Harta e pamjes së përgjithshme	Shtirja horizontale
Plani i shtrirjes vertikale	Seksioni kryq	Shtirja vertikale
Seksioni kryq	Shtirja horizontale	Planet e vendndodhjes së peizazhit të planifikimit të detajuar
Shtirja horizontale	Shtirja vertikale	Shenjëzimet dhe planet e shenjëzimeve
Shtirja vertikale	Planet e ndërtimit	Planet e vendndodhjes me pajisjet rrugore
Skica ndërtimi	Planet e vendndodhjes së peizazhit të planifikimit të detajuar	Planet e instalimit të sinjaleve
Planet shoqërues të vendndodhjes së masave të peizazhit	Shenjëzimet dhe planet e shenjëzimeve	Inxhinieria e trafikut gjithëpërfshirës
Shenjat ekzistuese dhe planet e shenjëzimeve	Planet e vendndodhjes me pajisjet rrugore	Dokumentet për planifikimin e sinjalizimit
	Kryqëzimet me të gjitha shenjat dhe sinjalet, planet e instalimit	
	Inxhinieria e trafikut gjithëpërfshirës	
	Dokumentet për planifikimin e sinjalizimit	

Tabela 3. Dokumentet e planifikuar për ASR-në

Ekipi i auditimit mund të kërkojë informacione të tjera, të cilat i gjykon si të nevojshme për kryerjen e detyrës profesionalisht.

4.2.2 Ndërmarrja e auditimit të sigurisë rrugore

Analiza e informacionit paraprak

Audituesi studion materialet e projektit (vizatimet e projektimit dhe informacione të tjera të parashikuara), duke marrë në konsideratë ndikimin e mundshëm mbi të gjitha llojet e ndryshme të përdoruesit të rrugës. Të gjitha informatat duhet të vlerësohen. Në këtë kohë, shpesh është e mundur për të identifikuar zonat e projektit të cilat përmbajnë probleme të mundshme të sigurisë. Audituesve duhet t’u jepet kohë e mjaftueshme për të kryer një ASR në mënyrë që të sigurohet se është e plotë.

Studimet në terren

Studimet në terren janë të rekomanduara për fazën 1 dhe 2 të auditimit. Në mënyrë që të fitohet një kuptim i qartë i projektit, është e rëndësishme që audituesi kryen zakonisht një inspektim zone. Inspektimet në terren lejojnë audituesin për të parë se si ndërvepron me propozimin përreth dhe pranë rrugëve. Ata ofrojnë ekip të auditimit me një ndjenjë për kushtet ekzistuese. Zona e inspektimit duhet të caktohet sipas kushteve të ngjashme me realitetin e trafikut dhe ato mjedisore.

Të dyja së bashku, si koha e inspektimit natën dhe koha ditën janë thelbësore për të vlerësuar situatën. Ajo gjithashtu mund të jetë e nevojshme për të parë vendin në kohë të tjera të ditës (p.sh. pasi mbaron shkolla, gjatë rrugës së tregut, e aktivitete të tjera).

Kur auditohen fazat 1 dhe 2, audituesi duhet të vihet vetë në pozitën e përdoruesve të ndryshëm të rrugës (drejtues mjeti, çiklist dhe këmbësor) duke përdorur dokumentet e planifikimit, në mënyrë që ai mund të gjykojë mbi sigurinë rrugore, nga pikëpamja si të gjithë përdoruesit e tjerë të rrugës.

Në fazën e 3 dhe 4 të auditimit, audituesi mund të shikojë një rrugë të re dhe kryerjen e auditimit në terren.

Me qëllim që të vlerësojnë objektin e trafikut nga pikëpamja e të gjithë përdoruesve të rrugës, audituesi duhet të inspektojë rrugën nga perspektiva e drejtuesve të automjeteve, çiklistët, këmbësorët etj., sipas nevojës.

Rishikimi i dokumentacionit

Audituesi kryen auditimin e sigurisë mbi bazën e përvojës së tij personale dhe njohurive të tij të sigurisë rrugore. Për të siguruar që aspektet e sigurisë nuk janë anashkaluar gjatë kësaj përvoje-procedurë bazë, mund të përdoren **listat kontrolluse** (shih listat në fund të udhëzuesit dhe shtojcën “A”) për të ndihmuar në këtë proces.

Audituesit duhet të kenë pyetjet e mëposhtme bazë në mendje:

- Kush mund të lëndohet dhe në çfarë mënyre?
- A është zgjidhje e sigurt për të gjithë përdoruesit e rëndësishëm të rrugës për përdorimin e objektit të trafikut?
- A është projekti që është zgjedhur më i mirë për sigurinë e trafikut?
- A duket e këshillueshme që gjetjet e reja në lidhje me sigurinë në komunikacionin rrugor dhe projektimin të bëjë një ndryshim të projektit?

Listat e ndryshme kontrolluese janë zhvilluar për faza të ndryshme të zhvillimit të projektit dhe janë bashkangjitur si anekse të këtij udhëzuesi. Lista e plotë është e pranishme me pyetje të ndryshme lidhur me sigurinë e të gjithë përdoruesve, por ata nuk janë të vetmit. Ata identifikojnë çështjet dhe problemet që mund të lindin në fazën përkatëse të një auditimi.

Në listat kontrolluese për autostradat dhe rrugët interurbane janë përfshirë edhe pyetje mbi situatën tipike në lidhje me rrugën, seksionin që lidh fshatra të vegjël dhe vendbanimet lineare, të cilat shpesh nuk kanë karakter të kalojnë përmes rrugëve, por edhe të krijojnë konflikte me përdoruesit e rrugës të pambrojtur.

Audituesit duhet të përdorin gjykimin e tyre për sigurinë në ndonjë tipar të veçantë.

Listat kontrolluese janë vendosur paraprisht me poshtë:

- Shfrytëzimin e plotë të standardeve teknike dhe specifikimeve në mënyrë për të përmirësuar sigurinë rrugore;
- Gjetjet nga hetimet lokale të aksidentit;
- Rezultatet e punës kërkimore të reja;
- Përvoja e fituar nga auditimet më parë;
- Gabime që ndodhin rregullisht gjatë projektimit.

Përfundimi i auditit dhe raporti

Ekipi i auditimit përgatit një raport mbi auditimin e sigurisë rrugore, i cili duhet të jetë konciz me një përshkrim të shkurtër dhe të qartë të problemeve të identifikuara të sigurisë.

Rezultatet e auditimit janë përshkruar në raport, i cili i dorëzohet klientit. Raporti duhet të përshkruajë qartë dhe me saktësi rëndësinë e projektit, fazën e auditimit, anëtarët e ekipit të auditimit dhe procesin e auditimit, por roli kryesor i raportit të auditimit është që të përshkruajë aspekte të

projektit që përfshijnë shqetësime për sigurinë rrugore dhe të bëjë rekomandime në lidhje me veprimet korrigjuese.

Raporti me shkrim i auditimit përmban listat e problemeve të sigurisë që janë identifikuar. Audituesit duhet të tregojnë se si të eliminojnë defektet apo t'i zbusin ato. Ka mundësi për shembull për të dhënë qartë këshilla në raportin e ASR-së me referenca të udhëzimeve dhe normave. Nga ana tjetër disa skica me ide për përmirësime në një shtojcë të organit kryesor të raportit mund të jenë të dobishme. Kjo nuk është nëse audituesi e ndjen për të krijuar një projekt të ri, por ai mund të bëjë propozime për të shmangur probleme të sigurisë.

Raporti i auditimit duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

1. Detaje të përgjithshme dhe të hollësishme të projektit: Emri i projektit, fazat e auditimit, data e auditimit, si dhe datat dhe koha e çdo inspektimi, kushtet e motit gjatë inspektimit etj. Një deklaratë në lidhje me cilën fazë të procesit të auditimit ka të bëjë raporti. Detajet e ekipeve të përfshira. Një vështrim mbi përmbajtjen e dokumentacionit të audituar.

2. Rezultatet e auditimit: Detajet e mangësive të veçanta të identifikuara, me arsyet pse këto konsiderohen si mangësi. Rekomandimet për veprime që mund të merren për të hequr apo reduktuar ndikimin e këtyre mangësive.

Në trafikun e hapjes dhe fazat e hershme operative, fotografitë duhet të shoqërojnë raportin e auditimit.

Klienti për të dhënë një mundësi të mirë për të vlerësuar rezultatet e auditimit duhet të strukturojë të metat në probleme dhe vërejtje në dy nivele:

Detyra e raportit mbi auditimin e sigurisë rrugore është të raportojë në mënyrë koncize mbi aspektet e projektit që paraqesin rrezikshmëri dhe të bëjë rekomandimet e duhura mbi veprimet korrigjuese. Rekomandimet zakonisht diktojnë natyrën e zgjidhjes së problemit pa hyrë në detaje, përgjegjësi e cila është e projektuesit. Nuk është e nevojshme të përmenden elemente pozitive të projektimit, presupozohet që të gjitha projektet përmbajnë elemente të mira.

- Problemet janë rezultatet me një marrëdhënie të qartë për sigurinë e rrugëve. Kjo mangësi do të thotë se do të rrisë rrezikun aksident apo ashpërsi. Me të filluar ndryshimet e projektimit, aksidentet dhe rreziqet duhet të reduktohen. Audituesi mund të ilustrojë rekomandimet e tij me gojë ose me skica, por kjo nuk është punë e audituesit për të hartuar ndryshimet.

- Vërejtjet duhet të bëhen në lidhje me rezultatet të cilat ndoshta nuk do të çojnë në aksidente më shumë, por mund të përmirësojnë qëndrueshmërinë e projektit ose mund të lehtësojnë kërkesat për përdoruesit e rrugës etj. Përmbajtja e vërejtjeve gjithashtu mund të jenë të lidhura me hapat e ardhshëm të projektit për të udhëhequr një vëmendje të veçantë për çështje të sigurisë të projektuesit.

Është shumë e rëndësishme që të shkruhen më poshtë rezultatet, vizatimet ose dokumentet e tjera të punës dhe kjo duhet të mbahet si dëshmi. Në këtë mënyrë, lista kontrolluese mund të jetë e dobishme si dokument pune. Në rreshtin e fundit “komente” audituesi mund të bëjë vërejtje nëse më vonë Klienti do të kërkojë për disa shpjegime. Gjithashtu në rast të rezultateve të cilat nuk janë të përshtatshme dhe në fund nuk është pjesë e raportit zyrtar, kjo do të jetë e dobishme për të shënuar ata atje.

Kjo mund të ndodhë gjatë procedurës së auditimit kur audituesi gjen mangësi në dokumentacionin e projektit të cilat nuk janë të lidhura me sigurinë. Kjo nuk është e rekomanduar që të përfshijë këto rezultate në raportin e auditimit. Për më tepër është rekomanduar që të përmendet kjo në një shkresë ose në një aneks (jozyrtar të veçantë).

NJË RAPORT TIPIK AUDITIMI PËRMBAN:

a) Informacionin rreth projektit - emrin e rrugës, lokalitetin (p.sh. fshatin), fazën e projektimit kur kryhet auditimi. Gjithashtu, përshkruan shkurtimisht projektin dhe objektivat e tij.

b) Historikun e projektit:

- emrat e anëtarëve të ekipit të auditimit, dhe të entit pronar;
- një plan të projektit (me numrat e vendosur mbi të);
- datat kur janë kryer inspektimet dhe kur janë mbajtur takimet;

- një listë të dokumenteve të përdorura gjatë auditimit;
- fotografitë e problemeve serioze të sigurisë.
c) Gjetjet dhe rekomandimet - një seri të gjetjeve rreth mangësive në siguri që janë identifikuar, me rekomandimet (të një natyre të përshtatshme) direkt pas secilës gjetje. Kjo do të jetë pjesa më kryesore e raportit.
d) Deklaratën formale - një deklaratë përfundimtare, të firmosur nga të gjithë anëtarët e ekipit, që vërteton ndërmarrjen e auditimit.

Rekomandimet duhet të identifikojnë me fjalën “Urgjent” problemet e sigurisë që konsiderohen të jenë me rrezik, dhe që kërkojnë vëmendje të menjëhershme për eliminim, mbrojtje ose paralajmërim. Në mënyrë të ngjashme, edhe problemet që paraqesin rrezikshmëri të lartë duhet të identifikohen me fjalët “Rrezikshmëri e lartë”. Këto dy kategori nuk janë përjashtuese. Përdorimi i tyre nuk do të thotë që problemet e tjera të identifikuar janë të parëndësishme. Problemet më pak serioze mund të quhen si të mesme ose me rrezikshmëri të ulët.

Shkruajtja e rekomandimeve

Është përgjegjësia e projektuesit dhe jo e audituesit që të marrë në konsideratë zgjidhjet optimale dhe të bëjë riprojektimet përkatëse (nëse duhet). Zakonisht, një rekomandim auditimi duhet të diktojë *drejtimin* nga duhet kërkuar zgjidhja dhe jo të specifikojë zgjidhjen. Në fund të fundit, audituesit nuk i njohin të gjitha mundësitë dhe kufizimet e projektit. Një rekomandim i përshtatshëm mund të ishte:

“Sheshim i mbushjes ose rrethim i saj”, ndërkohë që “instalimi i një rrethimi mbrojtës” mund të jetë shumë përshkruar, pasi fokusohet në një zgjidhje të vetme të mundshme. Por ndonjëherë, “rekomandimi” dhe “zgjidhja” ndahen me një vijë. Rekomandimet e formuluar duhet:

- të jenë konstruktive rreth mundësisë së zgjidhjes së problemit;
- të jenë realistë, duke marrë në konsideratë seriozitetin e problemit dhe koston e zgjidhjeve;
- pasqyrojnë zgjidhjet me kosto të ulët/të lartë dhe afatshkurtra/të gjata;
- shmangin riprojektimet ose specifikimin e zgjidhjeve në detaje, por në të njëjtën kohë nuk duhet të jenë aq sipërfaqësor dhe të përgjithshëm sa klienti të mos kuptojë thelbin e problemit/zgjidhjes.

Raporti përfundimtar i dërgohet NJAISR-së dhe nëpërmjet saj edhe klientit.

4.2.3 Përfundimi i auditimit të sigurisë rrugore

Pas marrjes së raportit të ASR-së, klienti duhet të shqyrtojë problemet e treguara dhe propozimet dhe të marrë një vendim se si projekti duhet të vazhdojë. Klienti i referohet raportit të auditimit për projektuesin.

Takimi përfundimtar

Një takim sqarimi mes klientit, projektuesit dhe audituesve dhe, nëse duhet, me pjesëmarrjen e një përfaqësuesi të NJAISR-së, mund të jetë shumë i dobishëm për të diskutuar rezultatet e auditimit. Është e rëndësishme që udhëheqësi i ekipit të auditimit, lideri projektimit dhe klienti të jenë të pranishëm në mënyrë që të gjitha palët mund të kuptojnë qartë çështjet e ngritura.

Takimi nuk duhet parë si një mundësi për të kundërshtuar rekomandimet. Takimi mund të përbëjë një mundësi për projektuesin për të kërkuar sugjerime për zgjidhjen e problemeve të identifikuar.

Përgjigje të raportit të auditimit

Klienti shqyrton raportin zyrtar të auditimit dhe konsideron problemet dhe propozimet e treguara.

Klienti mund t’i kërkojë projektuesit të komentojë dhe t’u japë përgjigje rekomandimeve të raportit, por **klienti më në fund vendos** nëse rekomandimet do të miratohen apo jo. Ai ka për të përcaktuar nëse, dhe deri në çfarë mase, vërejtjet dhe propozimet në raportin e auditimit do të çojnë në

ndryshime të projektit. Të gjitha rekomandimeve duhet t'u jepet vëmendje e duhur. Ato që janë të pranuar duhet të zbatohen pa vonesë.

Këto probleme të identifikuar që konsiderohen si të parëndësishme, jashtë termave të referencës ose që zgjidhjet e rekomanduara nuk janë konsideruar të përshtatshme duhet të adresohen me anë të një përgjigje formale. Përgjigja duhet të jepet drejtpërdrejt NJAISR-së dhe nga këta grupit të auditimit. Është e rëndësishme që kjo përgjigje zyrtare i jep arsye pse rekomandimet nuk janë pranuar. Kjo përgjigje vepron si një dëshmi dhe lë gjurmë në procesin e vendimmarrjes.

Secili rekomandim i raportit të auditimit të sigurisë rrugore duhet të marrë njërën nga përgjigjet e mëposhtme:

- pranohet i plotë dhe projektohet zgjidhja për kalimin ose zbutjen e problemit, sipas rekomandimit ose në një mënyrë tjetër po aq efektive;
- pranohet pjesërisht ose “në parim”, por për shkak të kufizimeve të tjera, zbatohen ndryshime të cilat sjellin vetëm zgjidhjen e një pjese të problemit; ose
- nuk pranohet aspak.

Në rastin e rishikimit të rrugëve ekzistuese, inxhinieri rajonal do t'i përdorë gjetjet për të formuluar programet e ardhshme për pikat e zeza të aksidenteve.

Kopjet duhet t'i paraqiten ekipit të auditimit për informacion dhe, gjithashtu, të ruhen në dosje për referenca të ardhshme.

TË PRANOHET OSE JO ...

Si vendos një menaxher projekti për të pranuar ose jo një rekomandim nga auditimi? Kjo pyetje zakonisht ngrihet vetëm për rastet e rekomandimeve “të kushtueshme” ose “të vështira për t'u përfshirë”.

Një pjesë e përgjigjes mund të jepej në fillim të procesit të projektimit: nëse një auditim mund të ishte ndërmarrë më herët? Sa më herët të ndërmerret auditimi, aq më shpejt mund të zgjidhet një problem. Me fjalë të tjera problemi mund të zgjidhet më lehtë ose më me pak kosto. Por nëse, për shembull, koncepti i projektit përmban një gabim themelor sigurie, zbulimi i tij në fazën e projektimit të detajuar mund të jetë presion për secilin për të pranuar një rregullim që mund të mos funksionojë.

Kur përballlet me një rekomandim auditimi të vështirë për t'u zgjidhur, menaxheri i projektit duhet të marrë në konsideratë:

- shanset që ky problem të çojë në rreziqe (sa shpesh mund të shfaqen plagosje);
- seriozitetin e atij rreziku;
- koston për riparimin e problemit (mund të ketë disa trajtime alternative); dhe
- efektivitetin e një riparimi në uljen e rrezikut.

Kjo kërkon gjykim inxhinierik. Menaxheri i projektit mund të kërkojë këshillë shtesë nga specialistë të sigurisë rrugore për menaxhimin e riskut. Arsyet për mospranimin e një rekomandimi duhet të dokumentohen në mënyrën e duhur.

Pas vendimit të klientit, projektuesi ndryshon skemë në përputhje me ndryshimet e pranuar dhe puna është zbatuar. Klienti do të vendosë nëse do të ishte e nevojshme të ketë një përsëritje të pjesshme të ASR-së për të kontrolluar dokumentacionin e ndryshuar. Kjo varet nga llojet e ndryshimeve në projektim, në disa raste do të jetë e mundur për të bërë ndryshime në fazën e projektit tjetër. Në rast dyshimi, klienti duhet të dërgojë për audituesit dokumentet përkatëse.

Përgjigja me shkrim për raportin e auditimit do të bëhet pjesë e dokumentacionit të projektit.

Në rastet e refuzimit të kërkesave të auditimit nga klienti, me implikime serioze negative për sigurinë rrugore, audituesi duhet të informojë NJAISR-në në mënyrë të shkruar dhe mund të kërkojë MPPT-në për arbitrazh.

Monitorimi

Një element kyç në tërë procesin e ASR-së është pashapja. Është me rëndësi jetike që performanca në sigurinë e projektit është monitoruar në intervale të caktuara. Është e zakonshme që kjo të jetë disa muaj pas hapjes së rrugës për trafikun. Në këtë mënyrë, vlefshmëria e vendimeve të marra mund të kontrollohet dhe të modifikohet për skemat e ardhshme, nëse është e nevojshme.

Raportet e ASR-së dhe vendimet e klientit janë dokumente të rëndësishme, të cilat do të bëhen pjesë e dokumenteve të projektimit dhe ndërtimit. Të gjitha dokumentet përkatëse duhet të mbahen të sigurt si dëshmi.

PJESA C. RAPORTIMI I AUDITIMIT TË SIGURISË RRUGORE

5. MANGËSITË TIPIKE TË SIGURISË RRUGORE

5.1 Të përgjithshme

Një informacion shumë i vlefshëm mund të jetë fituar nga studimi modelet e rrëzimit mbi lloje të ndryshme të rrugëve. Për më tepër, hulumtimet e vazhdueshme mund të jenë gjithashtu një burim i informacionit mbi përmirësimet e mundshme në mangësitë e sigurisë, madje edhe kur në këtë hulumtim nuk janë futur ende standardet dhe specifikimet e përshtatshme teknike.

Ky kapitull nuk mund të përpiqet për të përshkruar të gjithë faktorët e një përplasje që janë të lidhura drejtpërdrejt me çështjet e projektit, por fokusohet në karakteristikat kryesore të një përplasjeje që janë veçanërisht të zbatueshme për një lloj të veçantë në rrugë. Mangësi të rëndësishme që mund të ketë një efekt kritik së bashku në numrin dhe ashpërsinë e përplasjes janë të përfshira gjithashtu.

Një nga propozimet më të rëndësishme për ASR-në është:

M.q.s. njerëzit bëjnë gabime: të minimizohen mundësitë për gabime në trafikun rrugor. Në qoftë se gabimet ende nuk janë bërë minimizohen pasojat.

ASR-ja duhet të bëhet nga pikëpamja e çdo lloj përdoruesi rrugë. Për dy fazat e para të ASR-së, auditimi do të kryhet me “stimulim virtual” të objekteve të trafikut.

Siç është treguar më lart, përdoruesit e rrugës dhe sjellja e tyre janë të paktën një faktor kontribues në një numër të madh të aksidenteve. Gjithmonë duhet të kihet parasysh se kapacitetet e trafikut duhet të jenë në mënyrë të tillë që të gjithë shoferët mund të marrin një ide të qartë mbi gjendjen e projektimit të rrugëve, shenjat, shenjëzimet etj., dhe do të ndihmohen që të marrin vendime dhe veprime të drejta në momentin e duhur.

Kjo do të thotë se duhet të mendohet gjithmonë për të ashtuquajturën “Faktori njeri” në procesin e projektimit dhe auditimit dhe për të lehtësuar kërkesat për shoferë dhe për të shmangur “mbingarkesat” gjatë përdorimit të rrugës. Prandaj gjithmonë duhet të shmangen:

- shpejtësi jashtë normave;
- shpejtësi të lartë absolute;
- dallimet në drejtim;
- situata të paparashikueshme.

Për të përmirësuar sigurinë rrugore duhet të paralajmërohen:

- shoferët në rastin e situatave të jashtëzakonshme;
- ndryshimet në lidhje me kushtet e rrugës;
- shoferët në rastin e pikave ose seksioneve të konfliktit.

Auditimet duhet të ndihmojnë për ndryshim, në mënyrë që përvoja e specialistëve të sigurisë rrugore e aplikuar në një fazë mund të shërbejë për projektimet e ardhshëm. Mundësitë për ndryshim përfshijnë:

- Reflektimi brenda projektit;
- Reflektimi te projektet e tjera brenda së njëjtës zyrë projektimi. Garantimi i qarkullimit dhe diskutimit brenda zyrës i raporteve të auditimit dhe atyre të veprimeve korrigjuese. Trajtimi i problemeve që kanë të bëjnë me “rishikim në probleme të ngjashme”, “standard kundrejt sigurisë” etj. Përfshirja e projektuesve në ekipet e auditimit (në projektet me të cilat nuk kanë lidhje).

- Reflektimin e përgjithshëm te profesioni i projektuesit. Përfshirja e pikave të auditimit nëseminaret profesionale.
- Reflektimin ndaj standardeve të rishikuara.
- Reflektimin ndaj audituesve. Audituesit informohen rreth përgjigjes ndaj auditimit të tyre.

Një auditim nuk është kontroll i përputhshmërisë me standardet; ai është një vlerësim i nivelit të sigurisë së një projekti pas ndërtimit të tij dhe vënies në punë ose një kontroll “i përputhshmërisë me

qëllimin e tij”. Përputhshmëria tenton të sjellë qëndrueshmëri të trajtimit të përdoruesve të rrugës. Rekomandimet e audituesit duhet ta venë në dijeni projektuesin në lidhje me këto situata, nëse kemi siguri të kompromentuar, dhe të kërkojë aplikimin e standardeve dhe udhëzuesve përkatës. Por, siguria nuk vjen automatikisht nga përputhja me standardet dhe udhëzimet.

5.2 Mangësitë tipike

5.2. Autostradat dhe rrugët interurbane

Elementet e projektit

Elemente të projektimit të rrjetit të rrugëve mund të kategorizohen si më poshtë:

- radhitje e seksionit (horizontal dhe vertikal);
- projektimin e kryqëzimeve dhe *interchange*-ve;
- seksion kryq.

Elementet e projektimit duhet të jenë në përputhje me funksionin e rrugës në atë rrjet rrugor. Është e nevojshme për të zgjedhur një shpejtësi të mjaftueshme të projektuar me parametra kushtuar kthesave dhe seksioneve kryq.

Përveç kësaj, është e nevojshme të kihen parasysh problemet me mungesën e kontrollit të aksesit. Kjo do të thotë, për rrugët interurbane, të cilat janë projektuar me shpejtësi të lartë mund të merret me mend një ndikim i drejtpërdrejtë në sigurinë rrugore, i llojit dhe shpeshtësisë së pikave të hyrjes. Prandaj numri i hyrje-daljeve në pronat private duhet të minimizohet në rrugët ekzistuese ose të shmanget në rrugët e reja. Një zgjidhje alternative për përmirësimin e gjendjes ekzistuese është krijimi i rrugëve private të shërbimit, paralele apo duke riorganizuar një lidhje me një rrjet të mesëm. Numri i kryqëzimeve apo interseksioneve duhet të jetë i kufizuar dhe në mes dy kryqëzimeve rresht apo interseksioneve duhet të jetë një distancë e mjaftueshme.

Grupimi i seksioneve rrugore

Disa mangësi tipike që ndikojnë në sigurinë rrugore në **rrugët interurbane** janë:

- shtrirja horizontale: rreze në kundërshtim renditjeje (shpejtësi të ndryshme), përdorimi i rrezeve të vogla në pjesët me shpejtësi të lartë, ndryshimet e papritura të standardeve të shtrirjes pa ndonjë ndryshim;
- shtrirja vertikale: kthesa të vogla me kufizime shikimi, mungojnë korsi ngjitjeje për kamionë në rastin e pjerrësive në rrugë të shpejtë të pjerrëta, iluzione optike si “Fshehur-ulët”;
- kushtet e pamjaftueshme në lidhje me sytë me shikim të ndalur, të parit dhe pamje me tejkallim orientimi (sidomos në rrugët me një karrexhatë të vetme).

Projektimi i kryqëzimit dhe interseksionit

Një numër i konsiderueshëm i aksidenteve ndodh në kryqëzimet. Mangësi tipike në këtë fushë janë:

- Mungesa e korrelacionit ndërmjet shtrirjes dhe llojit të ndërprerjes, që do të thotë për të ndarë nivelin e rrugëve të shpejtësisë së lartë me rrugët me interseksione etj.;
- Interseksionet nuk janë të përshtatshme për njohuritë e shoferëve;
- Mungesa e kushteve të pamjaftueshme të shikimit, penguar nga pajisje të rrugëve, shkurre, shtëpi etj.;
- Gjeometria e pasigurt si zgjidhjet –Y;
- Mungesa e kthesës së majtë në korsinë e rrugës kryesore;
- Mungesa e pjesëve të sinjalistikës së trafikut në rrugët me vëllim të lartë të trafikut;
- Kalim i pasigurt i pjesëve për këmbësorë dhe biçiklista.

Për më tepër siguria rrugore mund të përmirësohet me reduktimin e numrit të kryqëzimeve në rrjetin kryesor me shpejtësi të larta si një pjesë e planifikimit të rrjetit inteligjent. Përdorimi i rrethrotullimit në vend të kryqëzimeve duhet të jetë zgjidhja më e favorshme, sepse kjo ndihmon për të reduktuar numrin e pikave të konfliktit.

Probleme të tjera tipike të interseksioneve apo thyerjes së kryqëzimeve në nivel, janë zgjidhje të pamjaftueshme apo konfuze në lidhje me vëllimin e flukseve të trafikut.

Seksioni kryq

Në ASR shpesh mund të identifikohen mangësitë e mëposhtme:

- Zgjedhja e gjerësisë së korsive nuk i korrespondon funksionit të rrugëve, pra korsitë nuk duhet të jenë 3,5 m të gjera si në shumicën e rasteve;
- Përdorimi i rrugëve vetëm me një karrexhatë me gjerësi totale tërthore të asfaltuara nga 11-12 m, të çon në një përdorim si 3 korsi me rreziqe të lartë për aksident;
- Rënie kryq e pamjaftueshme nëseksionin e drejtë (zakonisht duhet të jetë 2,5%);
- Mungesa e qartë ose zonat (një rrip toke ngjitur me rrugën pengesa e parrezikshme në të) apo “e rrugëve që falin” (ato ku pengesat janë të sigurta në mënyrë pasive);
- Mungesa e një mbilartësimi të mjaftueshëm;
- Kullim i pamjaftueshëm, mungesë kullimi në seksionet ku ka një ndryshim të drejtimit të pjerrësisë në kthesat nga ana e majtë në të djathtë, dhe në hendekët e seksioneve të kurmëzuara;
- Mungesa e bordurave të forta dhe të qëndrueshme;
- Rrugët me katër korsi fizikisht pa ndarje mesatare etj.;
- Instalimet pasive të sigurisë të zhdukura, të pamjaftueshme ose të pasakta përgjatë rrugës dhe në mesataret e rrugëve me dy karexhata;
- Objektet e sigurisë së këmbësorëve dhe të çiklistëve, shpesh të humbura, mungojnë ose janë me siguri të pamjaftueshme.

5.2.2 Njëpërmjet seksioneve rrugore dhe rrugët kryesore urbane

Me përjashtim të rrugëve dhe zgjidhjet me anashkalim për autostradat, të gjitha rrugët kanë pjesët të cilat janë për kalimin në fshatra, qyteza dhe qytete. Karakteri i seksionit përmes rrugës është ndikuar fuqimisht nga karakteri i zonës urbane. Ka dallime të mëdha krahasuar me gjendjen e seksioneve të autostradës në fshatra të vogla me rrugët urbane kryesore në qytetet e mëdha.

Për shkak të trafikut të përzier nëpër seksione rrugore, kërkesa të veçanta të përbërjes së trafikut duhet të jenë në fokusin e audituesit. Fëmijët, të moshuarit, dhe njerëzit me aftësi të kufizuara janë veçanërisht të rrezikuar në zonat me supe të ngritura. Shpejtësia e operacionit duhet të jetë jo më i lartë se 50 km/h nëse nuk ka ndarje të plotë (rrugë dytësore shërbimi, objekte kalimi të sigurt, si ura për këmbësorë).

Karakteristika shumë të dobishme të sigurisë janë trotuare të sigurta dhe vendkalime për këmbësorët, duke përfshirë ishuj strehimi qendre, si gjatë rrugës dhe në kryqëzimet. Duhet të funksionojnë rregulla të forta kundër parkimit në trotuaret. Shumë shpesh të gjitha nevojat e këmbësorëve dhe përdoruesit e tjerë të pambrojtur rrugorë janë injoruar dhe ata janë të detyruar të përdorin karrexhatën e lëvizjes më të shpejtë të trafikut.


Mangësi tipike që ndikojnë në sigurinë e projektimit përmes seksioneve rrugore dhe rrugët urbane të mëdha janë:

- Zgjedhja e operacionit/shpejtësi ligjore e papërshtatshme (më e lartë se 50 km/h pa ndarje të veçantë);
- Projekti nuk është i mjaftueshëm për t'i demonstruar shoferit situatën e veçantë gjatë seksionit rrugor. Nuk ka objekte për të mbështetur fizikisht kufijtë e shpejtësisë;
- Mbrojtje e pamjaftueshme e këmbësorëve dhe çiklistëve përgjatë rrugëve dhe në kryqëzimet.
- Kryqëzimet me sinjale trafiku: sinjale kontrolli që nuk konsiderojnë nevojat për të gjithë përdoruesit e rrugës, duke përfshirë mungesën e mbrojtjes për lëvizje kthim - majtas apo vonesa të tepërta për këmbësorët dhe çiklistët;
- Mungesa e mbrojtjes për kalimin e këmbësorëve dhe çiklistëve në pjesët e rrugës së hapur;
- Gjerësi e pamjaftueshme e seksioneve kryq, d.m.th., korsi shumë të gjera nëseksione përmes rrugës që të çojnë në një shpejtësi të rrezikshme, prandaj 3,25 m janë të mjaftueshme;
- Parkim pa kriter dhe mbushje e objekteve.

KËSHILLA SIGURIE PËR EKIPET E AUDITIMIT KRYQËZIMET

MINIMIZIMI I PIKAVE KONFLIKTUALE

Sa më i pakët të jetë numri i pikave konfliktuale, aq më i sigurt është një kryqëzim. Të kontrollohen projektet për të garantuar uljen e pikave konfliktuale në kryqëzimet madhore duke ulur numrin e pozicioneve ku mund të ketë përplasje. Rrethrotullimet kanë vetëm katër pika konfliktuale dhe janë një formë/metodë e sigurt për kontrollimin e kryqëzimeve. Ishujt e trafikut i ndajnë automjetet nga njëri-tjetri dhe sigurojnë strehim për këmbësorët.




DEVIJIMI NË RRETHROTULLIME

Devijimi është pjesë përbërëse e një projekti të sigurt rrethrotullimi. Devijimi ngadalëson trafikun dhe i drejton automjetet në drejtim të fluksit.

MAKSIMIZIMI I DISTANCAVE TË PAMJES

Bimësia, pajisjet e rrugës dhe objekte të formave të tjera mund të ndikojnë në distancat e pamjes. Të kontrollohet mbajtja e vijave të pamjes të hapura dhe të qarta – të sigurta.



 <p>Korsia qe duhet ruajtur (mbajtur)</p>	<p>VIJËZIMI NË KRYQËZIME</p> <p>Vijëzimi është thelbësor për përparësinë e kontrollit dhe për të garantuar të drejtën e përparësisë nga automjetet në përputhje me ligjin. Vijëzimet e ndalimit që jepen në diagram përdoren për të përcaktuar zonën e kryqëzimit dhe për të menaxhuar konfliktet ndërmjet automjeteve.</p>
<p>KËSHILLA SIGURIE PËR EKIPET E AUDITIMIT SINJALET RRUGORE DHE VIJËZIMET</p>	
<p>Drejtuesit e automjeteve marrin 90% të informacionit të nevojshëm në mënyrë vizuale. Sinjalet përfaqësojnë një pjesë të madhe të atij informacioni. Për një sinjalistikë të mirë duhen pasur parasysh 5 parime bazë: Sinjalet duhet të jenë:</p>	
	<p>TË SPIKATSHME – shenja duhet të jetë në një vend të dukshëm.</p>
	<p>TË QARTA – forma dhe ngjyra e shenjës, si dhe legjenda/simboli duhet të jenë lehtësisht të identifikueshme.</p>

	<p>TË KUPTUESHME – shenja duhet të jetë e kuptueshme</p>
---	---

KËSHILLA SIGURIE PËR EKIPET E AUDITIMIT SINJALET RRUGORE DHE VIJËZIMET

	<p>TË BESUESHME – mesazhi i përcjellë nga shenja duhet të jetë i besueshëm për drejtuesit e automjeteve. Kjo shenjë paralajmëron kalimin e këmbësorëve, por në fakt në rrugë nuk ka vijëzim të tillë! Drejtuesit e automjeteve i neglizhojnë të gjitha shenjat të cilat janë të pabesueshme.</p>
--	---

	<p>TË NJËTRAJTSHME – të gjitha shenjat për një çështje të caktuar duhet të jenë të njëjta dhe të vendosen në pozicione të ngjashme.</p>
---	--

Sinjalet shpesh vendosen si “zgjidhje të shpejta” për shumë situata të rrezikshme. Ato mund të jenë një zgjidhje e shpejtë dhe me pak kosto për një problem. Megjithatë, ekipet e auditimit të sigurisë rrugore duhet të marrin në konsideratë faktin nëse ngritja e një sinjali është zgjidhja më e mirë e një problemi. **Normalisht, zgjidhja më e mirë është largimi i vetë rrezikut dhe kësaj duhet t’i jepet përparësi.** Megjithatë, kur një rrezik nuk mund të largohet ose kostoja për largimin e tij është shumë e lartë, atëherë vendosja e një sinjali mund të shihet si zgjidhja më e mirë e mundshme. Sapo merret vendimi për përdorimin e një sinjali, duhet të sigurohet përputhshmëria e tij me 5 parimet bazë të përdorimit të sinjaleve.



Ekipe të auditimit duhet të garantojnë që projektet për rrugë me shpejtësi të lartë kërkojnë vija kufizimi anësore.

Këto skicime krijojnë një mjedis rrugor me më pak rrezik për drejtuesin e automjetit.

5.2.3 Formati i përgjithshëm i raportit mbi auditimin e sigurisë rrugore

Për çdo auditim të kryer do të hartohet një raport. Çdo raport mbi auditimin e sigurisë rrugore duhet të përmbajë:

1. Titullin e raportit

Përfshin emrin e projektit të rrugës dhe vendndodhjen. Nëse kërkohet, raportit i jepet një numër.

2. Përshkrim të shkurtër të projektit të rrugës

Përshkrim i shkurtër i projektit, përfshirë qëllimin ose objektivat e projektit dhe çështjet apo problemet e veçanta që synon të zgjidhë. Në rastin e një rruge ekzistuese përshkruhet shkurtimisht rruget dhe funksioni i saj. Jepet i gjithë informacioni dhe të dhënat e siguruar për auditim, përfshirë edhe raportet e tjera të mëparshme, informacionin mbi fluksin e trafikut, planet dhe vizatimet dhe çdo material tjetër të siguruar pas takimit fillestar.

3. Fazën në të cilën kryhet auditimi i sigurisë

Jepet tipi i auditimit (qoftë rrugë ekzistuese apo e re) dhe fazën në të cilën kryhet auditimi i sigurisë (p.sh. projektimi i detajuar).

4. Audituesit e sigurisë rrugore

Jepet lista e anëtarëve të ekipit të auditimit të sigurisë rrugore dhe titujt e tyre.

5. Datat e ASR-së

Përfshin datën e takimit fillestar dhe vizitat në objekt.

6. Gjetjet dhe rekomandimet

Një përshkrim i shkurtër i konstatimeve gjatë vizitave në objekt dhe rishikimi i materialeve të disponueshme. Rekomandimet për veprimet korrigjuese duhet të kategorizohen në “menjëherë”, “i/e nevojshme”, “preferueshëm” etj.

7. Deklarimin formal

Një deklaratë formale, e firmosur dhe me datë nga audituesit e sigurisë rrugore, që dikton që ata i kanë shqyrtuar referencat e dhëna, kanë inspektuar objektin dhe kanë identifikuar problemet e sigurisë të dhëna në raport.

8. Shtojca

Fotografitë e objektit, ndonjë hartë bazë ku janë shënuar volumet e trafikut dhe informacione të tjera të nevojshme.

6. TRAJNIMI I AUDITUESVE DHE ASPEKTET JURIDIKE

6.1 Eksperienca dhe trajnimi i audituesve

E rëndësishme është që audituesi të ketë përvojë të thellë në çështjet e sigurisë rrugore. Përbërja e ekipit do të varet nga madhësia dhe lloji i skemave që auditohen.

